



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT  
TË PUSHTETIT LOKAL



# PARTNERITETI PËR QEVERISJE TË HAPUR PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT 2026-2028

Fuqizimi i Transparencës, Pjesëmarrjes dhe Llogaridhënies

[mapl.rks-gov.net](http://mapl.rks-gov.net)

Tel; +383 (0) 38 200 64 209

Adresa; Ish ndërtesa e Rilindjes Kati  
11,12 dhe 13 Prishtinë

Prishtinë, mars 2026.

Open  
Government  
Partnership  
Kosovo



Open Government Partnership  
Kosovo

<i>Parathënie .....</i>	<i>2</i>
<i>Kapitulli I: Qeverisja e Hapur në Kosovë: Konteksti dhe bashkëkrijimi.....</i>	<i>3</i>
<i>1.1. Konteksti kombëtar dhe përafrimi strategjik .....</i>	<i>3</i>
<i>1.2. Një proces bashkë-krijimi i bazuar në dokumentim/dëshmi .....</i>	<i>3</i>
<i>1.3. Korniza institucionale për zbatim.....</i>	<i>6</i>
<i>Kapitulli II: Fushat dhe zotimet me prioritet për 2026–2028.....</i>	<i>7</i>
<i>Kapitulli III: Zotimet në detaje.....</i>	<i>8</i>
<i>Zotimi 1: Avancimi i transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare përmes platformës E-Komuna .....</i>	<i>8</i>
<i>Zotimi 2: Forcimi i publikimit proaktiv dhe transparencës në Ministrinë e Financave.....</i>	<i>17</i>
<i>Zotimi 3: Standardizimi dhe përmirësimi i publikimit proaktiv të dokumenteve publike dhe monitorimi i platformës së të dhënave të hapura.....</i>	<i>24</i>
<i>Zotimi 4: Rritja e transparencës dhe mbikëqyrjes publike të të dhënave kundër korrupsionit .....</i>	<i>31</i>
<i>Zotimi 5: Fuqizimi i mekanizmave për koordinim dhe monitorim të zbatimit të Planit të Veprimit për Qeverisje të Hapur 2026-2028 .....</i>	<i>37</i>
<i>Kapitulli IV: Zbatimi dhe monitorimi .....</i>	<i>42</i>
<i>4.1. Qeverisja dhe koordinimi.....</i>	<i>43</i>
<i>4.2. Procesi i shqyrtimit në mes të periudhës .....</i>	<i>43</i>

## Parathënie

Plani i Veprimit 2026–2028 paraqet një avancim strategjik në qasjen institucionale ndaj qeverisjes së hapur, i bazuar në mësimet e nxjerra nga zbatimi i planit të mëparshëm, plani përmban një vizion të qartë për adresimin e sfidave dhe shfrytëzimin e mundësive që mund të ndjekjen në vijim.

Cikli i analizës së Planit të Veprimit paraprak ofroi përvoja dhe mësimet të vlefshme, duke dëshmuar se një nivel i lartë ambicieje duhet të shoqërohet me masa konkrete, të fokusuara dhe të zbatueshme. Në këtë kontekst, ky plan përmban qasje “më të thellë, jo më të gjerë”. Në vend të një numri me të madh të zotimeve, janë përcaktuar pesë ndërhyrje strategjike prioritare, që adresojnë mundësitë për të përmirësuar transparencën, pjesëmarrjen dhe llogaridhënien në Kosovë. Kjo qasje nuk nënkupton ulje të ambicieve, por një fokusim më të madh drejtë përpjekjeve për të arritur rezultate të prekshme, konkrete dhe më të qëndrueshme.

Përzgjedhja dhe zhvillimi i këtyre zotimeve u realizuar përmes një procesi intensiv të bashkëpunimit me një qasje gjithëpërfshirës të bashkë-krijimit, që u zhvillua gjatë muajve nëntor 2025 - janar 2026. Përmes anketave dhe një punëtorie gjithëpërfshirëse me të gjithë palët e interesit u përmbyll cikli i hartimit të planit të veprimit në janar 2026, institucionet qeveritare dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile bashkëpunuan ngushtë gjatë gjithë procesit për të identifikuar sfidat kryesore, për të përcaktuar prioritetet dhe për të ndërtuar një ndjenjë të përbashkët përgjegjësie (sinergjie) duke krijuar tek të gjithë bashkëpunëtorët ndjenjën e pronësisë mbi përcaktimin e këtyre zotimeve.

Ky plan përbën një reflektim të drejtpërdrejtë të këtij bashkëpunimi, të mbështetur në dëshmitë dhe në nevojat e identikuara, artikuluara nga vet palët e interesit. Plani shërben si një udhërrëfyes për avancimin e një qeverisjeje më me gjithë përfshirje, të përgjegjshme dhe më të besueshme. Plan i veprimit përdorë transformimin digjital për ta bërë qeverisjen më efikase dhe më të lehtë e të qasme për qytetaret, ku përmes standardizimit të proceseve synohet garantim i barazisë dhe parashikueshmërisë, ndërsa përmes forcimit të mekanizmave të llogaridhënies synohet fuqizimi i rolit të qytetarëve në mbikëqyrjen e institucioneve publike për ta mbajné qeverinë me përgjegjëse. Ky është një plan i Kosovës dhe për Kosovën, i cili do të zbatohet në frymën e partneritetit në të cilën është bashkë-krijuar që nga fillimet e hartimit të tij.

Procesi i hartimit dhe bashkë-krijimit të Planit të Veprimit është mbështetur nga Qendra e Ekspertizës për Qeverisje Shumënivelëshe pranë Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.

## Kapitulli I: Qeverisja e Hapur në Kosovë: Konteksti dhe bashkëkrijimi

### 1.1. Konteksti kombëtar dhe përafrimi strategjik

Rrugëtimi i Kosovës drejt një qeverie më të hapur është i lidhur me agjendën e saj më të gjerë të zhvillimit kombëtar dhe reformës së administratës publike. Zotimet brenda Planit të Veprimit janë hartuar për të mbështetur dhe përshpejtuar drejtpërdrejt strategjitë kryesore kombëtare, duke përfshirë **Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026**<sup>1</sup>, **Strategjinë për Reformën e Administratës Publike 2022-2027**<sup>2</sup> dhe **Strategjinë për Qeverisje Elektronike 2023-2027**<sup>3</sup>. Plani trajton sfidat e identifikuar nga vëzhguesit vendas dhe ndërkombëtarë, duke përfshirë nevojën për më shumë transparencë sistematike, angazhim domethënës të qytetarëve përtej konsultimeve formale dhe krijimit të mekanizmeve me të fuqishëm kundër korrupsionit.

Zbatimi i **Planit të Veprimit për Qeverisje të Hapur 2023–2025**<sup>4</sup> ka qenë i kufizuar nga një kombinim i sfidave strukturore, të lidhura me kapacitetet dhe me procesin, të identifikuar si nga institucionet publike ashtu edhe nga organizatat e shoqërisë civile. Nga perspektiva e sektorit publik, pengesat më të mëdha ishin burimet njerëzore dhe ekspertiza e pamjaftueshme, ndarjet e kufizuara buxhetore, koordinimi i dobët ndërinstitucional dhe shpërndarja e paqartë e përgjegjësive midis akterëve zbatues. Këto kufizime shpesh u përkeqësuan nga prioritetet konkurruese të politikave, vështirësitë teknike dhe në disa raste, një fushëveprim me ambicieje shumë të larta të zotimeve në krahasim me kapacitetet e disponueshme.

Nga perspektiva e shoqërisë civile, sfidat përqendroheshin në cilësi dhe në kohën e pjesëmarrjes, veçanërisht mungesa e mekanizmeve të fuqishëm të monitorimit dhe llogaridhënies, rastet e angazhimit simbolik ku kontributet nuk u pasqyruan në mënyrë kuptimplote, si dhe përfshirja e vonuar e OSHC-ve në fazat kryesore të procesit. Shqetësime të tjera përfshijnë shtrirjen e kufizuar tek akterët e ndryshëm të shoqërisë civile, koordinimin e dobët brenda komunitetit të OSHC-ve dhe transparencën e pamjaftueshme në vendimmarrje. Gjetjet nga këto të dhëna, së bashku theksojnë nevojën për rregullime më të qarta të qeverisjes, angazhim më të hershëm dhe më gjithëpërfshirës të palëve të interesuara, mekanizma të forcuar të koordinimit dhe monitorimit dhe një përputhje më realiste midis zotimeve, burimeve dhe kapaciteteve institucionale gjatë ciklit të ardhshëm të Planit të Veprimit.

### 1.2. Një proces bashkë-krijimi i bazuar në dokumentim/dëshmi

Ky Plan Veprimi është rezultat i një metodologjie të qëllimshme të bashkë-krijimit, i bazuar në dëshmi, i hartuar për të adresuar mangësitë e identifikuar gjatë përpjekjeve të mëparshme.

Procesi filloi në fund të tetorit 2025, me një analizë të arritjeve, sfidave dhe mësimave të nxjerra nga zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit 2023—2025 të Kosovës, i cili ndihmoi në përcaktimin e hapave të mëtejshëm të proceseve rreth hartimit të planit të ri të veprimit, konkretisht të proceseve të bashkë-krijimit për të siguruar një qasje pjesëmarrëse me shumë palë të interesuara dhe duke sjellë perspektivat e sa më shumë palëve të interesuara që të jetë e mundur.

Takimi i parë i Grupit të Punës u thirr nga MAPL më **29 tetor 2025** për të shqyrtuar sfidat kryesore të hasura gjatë zbatimit të planit të mëparshëm dhe për të sqaruar kërkesat e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (PQH) për procesin e bashkëkrijimit. Gjatë diskutimit u theksua nevoja për

<sup>1</sup> [https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/08/Strategjia\\_liber\\_tri-gjuhe\\_finale-2016.pdf](https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/08/Strategjia_liber_tri-gjuhe_finale-2016.pdf)

<sup>2</sup> <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/01/PUBLIC-ADMINISTRATION-REFORM-STRATEGY-2022-2027.pdf>

<sup>3</sup> <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/2700/e-Government%20Strategy%20Kosovo%202023-2027.pdf>

<sup>4</sup> <https://www.opengovpartnership.org/documents/kosovo-action-plan-2023-2025-december/>

udhëzime më të strukturuar dhe të synuara mbi proceset e PQH-së, standardet e bashkëkrijimit dhe kërkesat procedurale përkatëse si për nëpunësit publikë ashtu edhe për përfaqësuesit e shoqërisë civile.

**Më 13 nëntor 2025**, u organizua një webinar (seminar online) mbi qeverisjen e hapur për përfaqësuesit e sektorit publik. Pas përfundimit të seminarit, pasoi një pyetësor, i hartuar për të mbledhur rekomandimet shpeshë mbi planin e mëparshëm dhe për të mbledhur ide dhe udhëzime të propozuara për zhvillimin e planit të ri.

**Më 21 nëntor 2025** u organizua një seminar online i dedikuar për qeverisjen e hapur me përfaqësues të shoqërisë civile, me qëllim sigurimin e përfshirjes së tyre aktive në hartimin e planit të ri të veprimit. Gjatë sesionit u prezantuan parimet e PQH-së dhe standardet e bashkë-krijimit, u krijua hapësirë që pjesëmarrësit të reflektonin mbi mësimet e nxjerra nga plani i mëparshëm, si dhe u zhvilluan diskutime mbi prioritetet dhe nevojat që do të zhvillohen. Pas seminarit, u shpërnda një pyetësor i strukturuar për të mbledhur në mënyrë sistematike komentet, propozimet dhe rekomandimet nga akterët e shoqërisë civile, me qëllim që ato të shërbenin si bazë për hartimin e planit të ri.

**Më 16 dhjetor 2025**, anëtarët e Forumit Kombëtar të Qeverisjes së Hapur u mbledhën për një takim pune të dedikuar për të sqaruar rolet, pritjet dhe organizimet praktike në lidhje me bashkë-krijimin e Planit të ri Kombëtar të Veprimit për Qeverisjen e Hapur. Diskutimi u strukturua rreth tre dimensioneve kryesore: rolet e anëtarëve para dhe gjatë fazës së bashkë-krijimit, si dhe përgatitjet logjistike dhe organizative të kërkuara për ngjarjen e bashkë-krijimit. Pjesëmarrësit së pari shqyrtuan përgjegjësitë e tyre *para fillimit të procesit të bashkë-krijimit*, duke theksuar rëndësinë e njohjes me parimet e Qeverisjes së Hapur dhe standardet e Qeverisjes së Hapur, duke reflektuar mbi mësimet e nxjerra nga Planin i mëparshëm i Veprimit të Kosovës (2023–2025), dhe duke konsultuar institucionet dhe rrjetet e tyre përkatëse për të identifikuar çështjet prioritare që ndikojnë në transparencë, llogaridhënie dhe ofrim të shërbimeve. Anëtarët u inkurajuan të promovojnë pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse, veçanërisht të grupeve të nën-përfaqësuar, mbi një qasje gjatë procesit nga mentaliteti - zgjidhjeje problemesh.

Takimi më pas u përqendrua në *rolin aktiv të anëtarëve të Forumit gjatë procesit të bashkë-krijimit*, duke nënvizuar se anëtarët pritjet të veprojnë si bashkë-hartues të Planit Kombëtar të Veprimit dhe jo si vëzhgues. Kjo përfshin mbështetjen e procesit të informimit dhe angazhimit përmes shpërndarjes së pyetësorëve në rrjetet e tyre, pjesëmarrjen aktive në diskutime dhe takime, kontributin në përcaktimin e agjendës së aktivitetit të bashkë-krijimit, si dhe angazhimin e vazhdueshëm gjatë gjithë fazës së hartimit të planit. Në fund, anëtarët e Forumit shqyrtuan *aspektet logjistike dhe përgatitore të aktivitetit të bashkë-krijimit i planifikuar në janar 2026*, duke përfshirë rregullimin e vendit të mbajtjes, strategjitë e informimit për të siguruar pjesëmarrje të larmishme, komunikimin publik dhe procesin e regjistrimit, koordinimin e kanaleve të komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe rolin e anëtarëve si bashkë-lehtësues të procesit. Vëmendje e veçantë iu kushtua nevojës për përpunimin sistematik të rezultateve të pyetësorëve, me qëllim identifikimin e grupeve tematike të zotimeve që po shfaqen dhe përcaktimin e institucioneve publike përkatëse si bashkëpronarë të mundshëm të zotimeve në të ardhmen.

Përveç takimeve dhe seminareve online të organizuara në kuadër të procesit të bashkë-krijimit, u realizua edhe një analizë e arritjeve, sfidave dhe mësimet të nxjerra nga zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit të Kosovës 2023–2025, siç është përmendur më sipër. Qëllimi i këtij vlerësimi ishte të ketë rol informues rreth hapave të ardhshëm në procesin e bashkë-krijimit të Planit të ri të Veprimit dhe në forcimin e metodologjisë së bashkë-krijimit. Gjetjet ndihmuan në formësimin e një qasjeje të përqendruar në pjesëmarrje të gjerë, shumë-palëshe duke siguruar që perspektivat e institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe akterëve të tjerë relevantë të mblidhen në mënyrë sistematike dhe të pasqyrohen në planin e ri. Andaj, u hartuan dhe u shpërndanë dy grupe të veçanta pyetësorësh si mjete kryesore të procesit të bashkë-krijimit: një i dedikuar për institucionet publike

dhe një për organizatat e shoqërisë civile. Pyetësorët u konceptuan për të mbledhur komente të strukturuar mbi Planin e mëparshëm të Veprimit, për të identifikuar fushat prioritare për reforma dhe për të grumbulluar propozime për zotime të ardhshme.

Pyetësorët e bashkë-krijimit për sektorin publik:

- Versioni në anglisht: <https://forms.gle/M1hyGB6J8muPSS287>
- Versioni në shqip: <https://forms.gle/kp48dYt3xvh8pFty5>
- Versioni në Serbisht: <https://forms.gle/ShSeAopEWJa7R81s5>

Pyetësorët e bashkë-krijimit për organizatat e shoqërisë civile:

- Versioni në anglisht: <https://forms.gle/sH5t8Y2rn41Nvyi96>
- Versioni në shqip: <https://forms.gle/tfezLYMpWv4XN7DcA>
- Versioni në Serbisht: <https://forms.gle/Y1GfvA9nYwEupGEt9>

Qëllimi që pyetësorët të ishin në dispozicion në dy gjuhë ishte që të ofronin qasje dhe gjithë përfshirje, duke mundësuar pjesëmarrjen e palëve të ndryshme të interesit në Kosovë. Gjithsej 31 respondentë dhanë kontributin e tyre, përfshirë 13 përfaqësues të shoqërisë civile dhe 18 përfaqësues të institucioneve të sektorit publik. Megjithëse ky kontribut ofroi një bazë të vlefshme dëshmish për procesin e bashkë-krijimit, nga raundet e ardhshme të konsultimeve do të përfitonin një numër më i madh respondentësh, me qëllim forcimin e mëtejshëm të përfaqësimit dhe përfshirjen e një game më të gjerë perspektivash. Rezultatet e këtyre pyetësorëve shërbyen si të dhëna kyçe për identifikimin e prioriteteve tematike si dhe informimin për hartimin e zotimeve në kuadër të Planit të ri Kombëtar të Veprimit.

Punëtorja kombëtare e bashkë-krijimit e mbajtur më **22 janar 2026 në Prishtinë** shënoi pikën kryesore të procesit të hartimit të Planit të Veprimit. Punëtorja u drejtua nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me mbështetjen e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës dhe mblodhi së bashku një grup të balancuar përfaqësuesish nga institucionet qeveritare dhe shoqëria civile për të formësuar së bashku prioritetet dhe strukturën e Planit të ri të Veprimit për Qeverisje të Hapur.

Punëtorja nuk u planifikua të jetë si një formë konsultimi, por si një platformë e vërtetë bashkëkrijimi, e bazuar në parimin e zërit të barabartë dhe pronësisë së përbashkët midis qeverisë dhe shoqërisë civile. Që në fillim, pjesëmarrësit ranë dakord për një parim kyç pune: objektivi ishte të bënin zgjidhje të përbashkëta në vend se të mbronin pozicionet institucionale, duke pranuar se suksesi i Planit të Veprimit varet nga përgjegjësia dhe partneriteti kolektiv.

Komponenti qendror i seminarit ishte një formë e strukturuar e përcaktimit të prioriteteve me shumë palë të interesuara. Duke u mbështetur në rezultatet e anketave përgatitore dhe në analizat e mëparshme, pjesëmarrësit shqyrtuan një listë të përzgjedhur fushash të mundshme për zotime, që përfshinin tema kyçe si pjesëmarrja qytetare, qeverisja digjitale, transparenca dhe lufta kundër korrupsionit. Përmes një procesi transparent votimi, pjesëmarrësit identifikuan së bashku zotimet me rëndësinë më të lartë strategjike dhe me vlerën më të madhe për publikun. Ky proces siguroi që prioritetet e reja të reflektonin një konsensus të mirëfilltë nder sektorial, të ndërtuar mbi dialog dhe bashkëpunim, dhe jo thjesht preferenca të njëanshme institucionale.

Për shembull, propozimi për fuqizimin e pjesëmarrjes qytetare përmes platformës E-Komuna mori 81.8% të votave, duke sinjalizuar një mandat të qartë dhe të përbashkët për t'i dhënë përparësi mjeteve digjitale të pjesëmarrjes që lidhin drejtpërdrejt qytetarët me vendimmarrjen në nivel komunal. Ndër zotimet e tjera që u renditën lart ishin forcimi i të drejtës për qasje në informata, zhvillimi i mjeteve digjitale për monitorimin e reformave, si dhe rritja e transparencës në prokurim.

Procesi i prioritizimit siguroi një bazë të qëndrueshme dhe të mbështetur në evidencë për fazën e hartimit, duke e harmonizuar Planin e Veprimit me pritjet e palëve të interesit dhe me agjendën më të gjerë të reformave në qeverisje në Kosovë.

Pas procesit të prioritizimit, pjesëmarrësit u ndanë në grupe pune shumëpalëshe, të përbëra nga përfaqësues të institucioneve publike dhe të shoqërisë civile. Grupet punuan duke përdorur modele të strukturuar për hartimin e zotimeve sipas formatit të PQH-së dhe një metodologji të qartë të përcaktuar paraprakisht. Në dy raunde pune të lehtësuara nga moderatorë, pjesëmarrësit:

- Përcaktuan qartë problemet kryesore, duke u bazuar në evidencë dhe në përvojën e palëve të interesit.
- Identifikuan shkaqet rrënjësore të problemeve dhe grupet përfituese që synohen të adresohen.
- Vlerësuan nismat ekzistuese dhe boshllëqet që kërkojnë ndërhyrje.
- Propozuan zgjidhje konkrete dhe përcaktuan vlerën e pritshme publike.
- Hartuan draft pikat kyçe për t'u arritur, rezultatet e pritshme dhe afatet kohore për zbatim.
- Analizuan mënyrën se si secili zotim do të kontribuojë në forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes.

Zotimet e hartuara u diskutuan më pas në seancë plenare, ku pjesëmarrësit i shqyrtuan, i sfiduan dhe ranë dakord mbi kriteret e rëndësisë, ambicies, realizueshmërisë dhe matshmërisë së tyre.

Ky proces i hartimit të përbashkët siguroi që zotimet të dalin si iniciativa të përbashkëta, e jo si propozime të njëanshme të hartuara nga lart-poshtë, nga qeveria. Pjesëmarrësit ranë dakord për një proces të vazhdueshëm dhe përsëritës, që përfshinë takime bilaterale dhe takime pune në grupe të vogla, me qëllim të përmirësimit të përmbajtjes së zotimeve, sqarimit të rolit udhëheqës institucional dhe bashkë-pronësisë nga shoqëria civile, si dhe finalizimit të indikatorëve dhe pikave kyçe për t'u arritur. Gjithashtu, u përcaktua një afat i qartë kohor për hartimin, miratimin dhe dorëzimin e Planit të Veprimit.

Në tërësi, punëtoria e bashkë-krijimit funksionoi si një platformë e strukturuar me pjesëmarrje, duke i shndërruar prioritetet e palëve të interesit në zotime konkrete dhe të zbatueshme. Njëkohësisht, ajo forcoi rëndësinë e kultivimit të një kulture institucionale të partneritetit dhe bashkëpunimit, e cila përbën themelin e procesit të Qeverisjes së Hapur në Kosovë.

**Më 3 shkurt 2026**, u mbajt një takim pune pasues me drejtues të caktuar nga institucionet publike dhe shoqëria civile për të realizuar një rishikim të fokusuar të Draft-Planit të Veprimit për Qeverisje të Hapur 2026–2028. Sesioni u përqendrua në përmirësimin e zotimeve të hartuara, ku pjesëmarrësit punuan bashkërisht në një hapësirë të përbashkët në Google Drive për të dhënë kontribute të detajuara dhe për të bërë rregullime duke përdorur formatet zyrtare të PQH-së për zotime. Ky takim pune praktik i mundësoi palëve të interesit të kuptojnë se çfarë duhet të përpilohet dhe të përmirësohet në përshkrimin e zotimeve: deklaratat e problemeve, aktivitetet, pikat kryesore për t'u arritur apo indikatorët, duke siguruar qartësi mbi pronësinë, realizueshmëri të zbatimit dhe përputhshmëri me standardet e PQH-së para se Draft-Plan i Veprimit të kalonte në fazën tjetër të përmbylljes dhe finalizimit.

### 1.3. Korniza institucionale për zbatim

Zbatimi me sukses i këtij Plani Veprimi do të koordinohet nga **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)**, e cila shërben si pikë kombëtare e kontaktit për PQH-në. Një Forum Kombëtar, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve kryesore qeveritare dhe një numër i barabartë organizatash të shoqërisë civile, do të mbikëqyrë zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e planit. Ky mekanizëm koordinimi siguron që fryma bashkëpunuese e fazës së bashkë-krijimit të përçohet në fazat e zbatimit dhe monitorimit, vlerësimit dhe të gjitha fazat e llogaridhënies.

## Kapitulli II: Fushat dhe zotimet me prioritet për 2026–2028

Bazuar në procesin e bashkë-krijimit, Kosova do të përqendrohet në pesë zotime strategjike për periudhën 2026–2028. Këto zotime janë hartuar për të qenë përforcuese të ndërsjella, duke krijuar një efekt sinergjik që mbështetë përparimin e qeverisjes së hapur në shumë fronte. Ato përfaqësojnë një përpjekje të përqendruar për të ndërtuar infrastrukturën thelbësore digjitale dhe institucionale për një qeverisje më transparente, më pjesëmarrëse dhe më llogaridhënëse.

#	Titulli i zotimit	Institucioni/et udhëheqëse	Vlerat e Avancuara të PQH-së
1	<b>Avancimi i transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare përmes platformës E-Komuna</b>	MAPL	Transparenca Pjesëmarrja e qytetarëve Llogaridhënia publike
2	<b>Forcimi i publikimit proaktiv dhe transparencës në Ministrinë e Financave</b>	MF	Qasja në informacion Transparenca Llogaridhënia publike
3	<b>Standardizimi dhe përmirësimi i publikimit proaktiv të informacionit të shërbimit publik</b>	AIP	Qasja në informacion Transparenca Pjesëmarrja e qytetarëve
4	<b>Rritja e transparencës dhe mbikëqyrjes publike të të dhënave kundër korrupsionit</b>	APK	Qasja në informacion Transparenca Llogaridhënia publike Pjesëmarrja e qytetarëve
5	<b>Forcimi i mekanizmave për koordinim dhe monitorim të zbatimit të Planit të Veprimit për Qeverisje të Hapur 2026-2028</b>	MAPL	Qasje në informacion Transparencë Llogaridhënie

Këto zotime u prioritetizuan duke e parë potencialin e tyre për të sjellë ndryshime sistematike. Ato shkojnë përtej iniciativave të pa planifikuara, ad-hoc (aty për aty), për të krijuar modele të standardizuara, të shkallëzueshme dhe të qëndrueshme për qeverisje të hapur, që mund të pilotohen (testohen) dhe më pas të zbatohen në të gjithë Kosovën. Çdo zotim bazohet në një përkufizim të qartë të problemit, i mbështetur në prova nga konsultimet me palët e interesit dhe analizat paraprake, dhe paraqet një plan zbatimi realist dhe të orientuar drejt pikave kyçe.

## Kapitulli III: Zotimet në detaje

### Zotimi 1: Avancimi i transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare përmes platformës E-Komuna

<b>Numri dhe Emri i Zotimit</b>	<b>Nr. 1 Avancimi i transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare përmes platformës E-Komuna</b>		
<b>Përshkrim i shkurtër i angazhimit</b>	Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në nivel lokal duke zgjeruar dhe institucionalizuar mjetet pjesëmarrëse brenda platformës E-Komuna, duke u mundësuar qytetarëve të kenë qasje në informacion, të paraqesin komente, propozime dhe raporte, si dhe të hulumtojnë përgjigjet e strukturuar dhe të dukshme publikisht të komunës. Ky zotim e forcon platformën E-Komuna si një mjet dypalësh për pjesëmarrje dhe llogaridhënie, i plotësuar me masa të synuara të informimit dhe të ngritjes së kapaciteteve për të mbështetur zbatimin dhe përdorimin efektiv të saj. Ai e zhvendos platformën nga një mjet ofrimi shërbimesh në një mekanizëm për përfshirje kuptimplote të qytetarëve në vendimmarrjen lokale: <a href="https://ekosova.rks-gov.net/Service/27">https://ekosova.rks-gov.net/Service/27</a>		
<b>Institucioni udhëheqës i zotimit</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)		
<b>Akterët mbështetës</b>	<b>Qeveria</b>	<b>Shoqëria Civile</b>	<b>Akterët e tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj.)</b>
	Zyra e Kryeministrit – Zyra për Qeverisje të Mirë; Agjencia e Shoqërisë së Informacionit; Komunat	Organizatat e shoqërisë civile si bashkë-zbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.	Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët
<b>Periudha kohore</b>	2026–2028		

#### Përkufizimi i Problemit

##### 1. Çfarë problemi synon të adresojë zotimi?

Pjesëmarrja e qytetarëve në nivel lokal në Kosovë mbetet e fragmentuar, e paqëndrueshme dhe kryesisht procedurale, ku mekanizmat ekzistues shpesh kufizohen në konsultime zyrtare pa mekanizma efektivë për kthim përgjigjeje dhe pa përgjigje pasuese institucionale të qartë. Për më tepër, qytetarët përballen me vështirësi në qasjen në informata të qarta dhe të strukturuar lidhur me mundësitë e pjesëmarrjes, si dhe në përcjelljen e mënyrës se si trajtohen kontributet e tyre nga komunat. Si rezultat, kontributet e qytetarëve rrallë janë të gjurmueshme përgjatë proceseve vendimmarrëse dhe kanë ndikim të kufizuar në politikat komunale, prioritetet dhe ofrimin e shërbimeve.

Ky problem prek qytetarët në të gjitha komunat, veçanërisht gjatë momenteve kyçe të vendimmarrjes,

siç janë përgatitja e buxhetit, planifikimi i investimeve lokale, zhvillimi urban dhe formulimi i politikave, ku pjesëmarrja është më e nevojshme, por shpesh ka më pak ndikim. Mungesa e mekanizmave të strukturuar, transparentë dhe të gjurmueshëm të pjesëmarrjes zvogëlon besimin në institucionet lokale, dobëson llogaridhënien dhe dekurajon angazhimin e qëndrueshëm qytetar.

Sfida buron nga mungesa e një qasjeje të institucionalizuar dhe të unifikuar ndaj pjesëmarrjes dhe transparencës në nivel komunal. Përgjegjësitë për menaxhimin e kontributeve të qytetarëve janë të paqarta, praktikat zbatohen në mënyrë jo të qëndrueshme, ndërsa mjetet ekzistuese nuk janë të integruara në mënyrë sistematike në proceset e qeverisjes dhe as nuk përdoren gjerësisht nga qytetarët. Adresimi i këtij hendeku (boshllëku) kërkon forcimin e kornizës së qeverisjes për pjesëmarrje dhe transparencë, në vend që të mbështetet vetëm në konsultime të izoluara apo në mjete digjitale të pavarura.

## **2. Cilat janë shkaqet e problemit?**

Vazhdimësia e pjesëmarrjes së dobët dhe kryesisht formale e qytetarëve në nivel lokal nxitet kryesisht nga faktorë strukturorë dhe institucional, e jo nga mungesa e mjeteve digjitale. Një ndër shkaqet kryesore është niveli i ulët i vetëdijes së qytetarëve për të drejtat e tyre për pjesëmarrje dhe për mekanizmat e disponueshëm të angazhimit. Informacioni mbi mundësitë e pjesëmarrjes shpesh është i fragmentuar, komunikohet në mënyrë të paqëndrueshme ose nuk paraqitet në një formë të kuptueshme dhe miqësore për qytetarët, duke kufizuar kështu qasjen dhe gjithëpërfshirjen.

Në nivel institucional, komunave u mungon një kornizë e unifikuar dhe e standardizuar për menaxhimin e pjesëmarrjes së qytetarëve. Mekanizmat shpesh zbatohen në mënyrë ad hoc (aty për aty), pa procedura të qarta, pa përgjegjësi të përcaktuara dhe pa përcjellje pasuese të detyrueshme. Si rezultat, ciklet e reagimit janë të dobëta: kontributet e qytetarëve mblidhen, por nuk vlerësohen, dokumentohen apo reflektohen në mënyrë sistematike në proceset e vendimmarrjes. Mungesa e llogaridhënies së qartë për trajtimin e kontributeve të qytetarëve zvogëlon besimin në institucionet publike.

Strukturat e qeverisjes e thellojnë më tej këtë problem. Pjesëmarrja nuk është e integruar në mënyrë të qëndrueshme në proceset thelbësore të punës së komunave, si planifikimi i buxhetit, përcaktimi i prioritetëve të investimeve dhe hartimi i politikave. Rolet për koordinimin e pjesëmarrjes ndërmjet drejtorive shpesh janë të paqarta, duke bërë që angazhimi i qytetarëve të funksionojë si një proces paralel procedural, e jo si një praktikë e integruar e qeverisjes.

Edhe pse mjetet digjitale janë të disponueshme, efekti i tyre ka qenë i kufizuar, sepse nuk mbështeten në procedura të standardizuara, aktivitete për zhvillimin e kapaciteteve dhe mekanizma monitorimi, si dhe nuk përdoren gjerësisht nga qytetarët. Kjo konfirmon se shkaqet themelore të problemit janë kryesisht institucionale dhe organizative, ndërsa boshllëqet teknologjike luajnë një rol dytësor.

## **Përshkrimi i Zotimit**

### **1. Çfarë është bërë deri më tani për ta zgjidhur problemin?**

Në vitet e fundit, institucionet qendrore dhe lokale në Kosovë kanë ndërmarrë iniciativë të shumta për të përmirësuar transparencën, ofrimin e shërbimeve komunale dhe ndërveprimin me qytetarët. Këto përpjekje përfshijnë përdorimin e mjeteve digjitale, publikimin e informacionit përmes faqeve zyrtare të komunave dhe platformave online, organizimin e konsultimeve dhe dëgjimeve publike, si dhe iniciativat e pjesëmarrjes bazuar në projekte, të mbështetura nga partnerët e zhvillimit dhe organizatat e shoqërisë civile.

Në nivel lokal, komunat kanë testuar formate të ndryshme të pjesëmarrjes, si mbledhje publike, procese konsultative të lidhura me përgatitjen e buxhetit, dhe kanale për dhënien e reagimeve mbi shërbimet komunale. Në nivel qendror, reforma në qeverisjen digjitale dhe qasja në informacion publik kanë krijuar një mjedis më të favorshëm për transparencë dhe angazhim të qytetarëve.

Edhe pse këto iniciativë kanë zgjeruar qasjen në informacion dhe kanë krijuar mundësi shtesë për ndërveprimin e qytetarëve, ato kanë mbetur të pabarabarta dhe të fragmentuara nëpër komuna. Mekanizmat e pjesëmarrjes shpesh zbatohen pa standarde të përbashkëta, pa përgjegjësi institucionale të qarta dhe pa integrim sistematik në proceset e vendimmarrjes. Si rezultat, kontributet e qytetarëve nuk dokumentohen, nuk përcillen dhe nuk marrin përgjigje në mënyrë të vazhdueshme, si dhe rezultatet e pjesëmarrjes nuk përcillen gjithmonë tek qytetarët në një mënyrë transparente dhe të strukturuar.

Përpjekjet e mëparshme kanë vendosur kështu baza të rëndësishme, por ende nuk kanë sjellë

institucionalizimin e praktikave të pjesëmarrjes në nivel komunal. Mungesa e procedurave të unifikuara, të mekanizmave të monitorimit dhe të llogaridhënies së qartë për trajtimin e kontributeve të qytetarëve ka kufizuar qëndrueshmërinë dhe ndikimin afatgjatë të këtyre ndërhyrjeve.

## **2. Çfarë zgjidhje po propozoni?**

Ky zotim propozon zhvillimin e mëtejshëm dhe institucionalizimin e platformës E-Komuna si një mekanizëm i unifikuar kombëtar i pjesëmarrjes së qytetarëve, transparencës dhe llogaridhënies në nivel lokal. Platforma do të kalojë përtej rolit të saj aktual si një mjet për shërbime dhe do të përdoret në mënyrë sistematike për të mbështetur ndërveprimin e strukturuar midis qytetarëve dhe komunave gjatë proceseve kryesore të qeverisjes.

Ky zotim do të zgjerojë dhe konsolidojë modulet ekzistuese të pjesëmarrjes dhe do të prezantojë funksionalitete të reja që lejojnë qytetarët të dorëzojnë kërkesa, reagime, propozime dhe raporte në një mënyrë të strukturuar dhe të gjurmueshme. Komunitat do të detyrohen të ofrojnë përgjigje të standardizuara, në mënyrë dhe të dukshme për publikun, duke siguruar që kontributet e qytetarëve të njihen zyrtarisht, të përpunohen dhe të përcillen më tutje.

Për të siguruar përdorimin efektiv, ky zotim do të shoqërohet me masa të synuara informimi dhe ndërgjegjësimi që informojnë qytetarët mbi mundësitë e pjesëmarrjes dhe mbështesin përdorimin gjithëpërfshirës të platformës. Në të njëjtën kohë, aktivitetet për zhvillimin e kapaciteteve do të fuqizojnë aftësinë e komunave për menaxhimin e kontributeve të qytetarëve dhe për të integruar pjesëmarrjen në praktikën e përditshme të qeverisjes.

Ajo çfarë është më e rëndësishme, është se zgjidhja nuk kufizohet vetëm në zhvillimin teknologjik. Ajo përfshinë futjen e procedurave të standardizuara dhe udhëzimeve operative për pjesëmarrjen e qytetarëve, përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësiwe institucionale brenda komunave, si dhe angazhimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit të koordinuar nga MAPL, për të siguruar qëndrueshmëri, cilësi dhe llogaridhënie në të gjitha komunitat.

Duke integruar pjesëmarrjen në proceset institucionale, duke forcuar përdorimin e saj dhe duke siguruar transparencën e rezultateve, ky zotim adreson një pjesë të konsiderueshme të identifikuar të problemit. Edhe pse nuk do të zgjidhë të gjitha sfidat e lidhura me angazhimin qytetar, ai do të përmirësojë ndjeshëm strukturën, gjurmueshmërinë dhe ndikimin e pjesëmarrjes së qytetarëve, duke krijuar një model kombëtar i cili mund të zgjerohet dhe të jetë i qëndrueshëm, dhe i përshtatur me parimet e PQH-së.

## **3. Çfarë rezultate duam të arrijmë duke zbatuar këtë zotim?**

### **Rezultatet**

- Platforma E-Komuna e përmirësuar me module të standardizuara të pjesëmarrjes që i mundësojnë qytetarëve të dorëzojnë kërkesa, reagime, propozime dhe raporte mbi çështjet në një mënyrë të strukturuar dhe të gjurmueshme.
- Panelet dhe proceset e punës së komunës i mundësojnë ekipeve komunale të regjistrojnë, caktojnë, përcjellin dhe përgjigjen në mënyrë të qëndrueshme ndaj kontributeve të qytetarëve, përfshirë afatet e përgjigjeve dhe veprimet pasuese.
- Të dhënat e pjesëmarrjes të qasshme publikisht dhe të përmbledhura (në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave), përfshirë numrin dhe llojin e kontributeve të pranuar, normat dhe afatet e përgjigjeve, si dhe statusin e veprimeve pasuese.
- Udhëzime operative dhe procedura standarde (SOP) për komunitat mbi menaxhimin digjital të pjesëmarrjes dhe reagimeve, duke sqaruar rolet, përgjegjësitë, standardet minimale të shërbimit dhe rrugët e përshkallëzimit (procedurat për adresimin e çështjeve në instanca më të larta).
- Materiale të informimit dhe udhëzimit për përdoruesit, për të mbështetur vetëdijësimin e qytetarëve dhe përdorimin gjithëpërfshirës të mjeteve të pjesëmarrjes, të shoqëruara me trajnime dhe mbështetje praktike për stafin komunal.
- Procese më të thjeshta dhe të unifikuara për trajtimin e pjesëmarrjes dhe reagimeve, duke zvogëluar përdorimin e kanaleve të shpërndara dhe duke mundur përpunim më të shpejtë dhe më efikas të kontributeve të qytetarëve brenda komunës.

Ndryshime në praktika, sisteme dhe sjellje

- Praktika më të qëndrueshme dhe më transparente të pjesëmarrjes, fillimisht në komunitat pilot/zbatues dhe gradualisht në të gjitha komunitat, duke reduktuar konsultimet ad hoc ose

thjeshtë formale.

- Përgjegjësi dhe llogaridhënie më e lartë institucionale, e mbështetur në përgjegjësi të qarta, trajtim të gjurmueshëm të rasteve dhe reagime pasuese të dukshme për publikun.
- Përvojë më e mirë për qytetarët në proceset e pjesëmarrjes, pasi ata mund të shohin se si trajtohen kontributet e tyre dhe të marrin përgjigje më të qarta — duke kontribuar me kalimin e kohës në rritjen e besimit ndaj proceseve komunale.
- Një model kombëtar i zgjerueshëm për pjesëmarrjen dhe reagime digjitale në nivel lokal, të harmonizuara me parimet e PQH-së dhe të aftë të shtrihet në komuna dhe procese të tjera të qeverisjes, bazuar në përvojën dhe dëshmitë nga zbatimi.

Analiza e Zotimit	
Pyetjet	Përgjigjet (nëse nuk është e aplikueshme, përgjigjuni vetëm me N/A)
1. Si do ta promovojë transparencën zotimi?	<p>Ky angazhim promovon transparencën duke siguruar që kërkesat e qytetarëve, proceset e pjesëmarrjes dhe përgjigjet e komunave të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të bëhen të dukshme përmes platformës E-Komuna në një formë të strukturuar dhe të qasshme. Qytetarët do të kenë mundësi të përcjellin se si regjistrohen, përpunohen dhe trajtohen kontributet e tyre nga autoritetet komunale.</p> <p>Të dhënat e përmbledhura dhe anonim mbi pjesëmarrjen do të jenë të disponueshme publikisht, duke përfshirë informacionin mbi numrin dhe llojet e parashtresave, afatet e përgjigjeve dhe veprimet pasuese, në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky publikim i strukturuar i informacionit mbi pjesëmarrjen do t'u mundësojë qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe mediave të monitorojnë reagimin e komunave dhe të kuptojnë më mirë se si institucionet lokale menaxhojnë dhe trajtojnë kontributet e qytetarëve.</p>
2. Si do të ndihmojë zotimi në nxitjen e llogaridhënies?	<p>Zotimi forcon llogaridhënien duke vendosur detyrime të qarta për komunat për të pranuar, përpunuar dhe për t'iu përgjigjur kontributeve të qytetarëve përmes rrjedhave të punës të strukturuar dhe të gjurmueshme publikisht në platformën E-Komuna. Procedurat e përcaktuara dhe afatet kohore të përgjigjes i bëjnë përgjegjësitë komunale të qarta dhe të matshme.</p> <p>Informacioni i përmbledhur dhe anonim i kërkesave të qytetarëve, përgjigjet e komunave dhe veprimet pasuese do t'u mundësojnë qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe medias të monitorojnë performancën institucionale, të identifikojnë vonesat ose boshllëqet dhe të vlerësojnë qëndrueshmërinë e përgjigjeve. Kjo transparencë përforcon si llogaridhënien vertikale midis qytetarëve dhe autoriteteve lokale, ashtu edhe llogaridhënien e brendshme brenda administratave komunale.</p> <p>Duke integruar përcjelljen e përgjigjeve dhe raportimin në proceset e rregullta të punës së komunave, ky zotim e përfshinë llogaridhënien në praktikën e përditshme të qeverisjes, në vend që të mbështetet në raportime ad hoc. Me kalimin e kohës, kjo mbështet monitorimin sistematik, përmirësimin e vazhdueshëm dhe të mësuarit institucional në nivel lokal.</p>
3. Si do ta përmirësojë zotimi pjesëmarrjen e qytetarëve në përcaktimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?	<p>Ky zotim përmirëson pjesëmarrjen e qytetarëve duke integruar mekanizma të strukturuar dhe të vazhdueshëm të angazhimit në proceset e qeverisjes komunale përmes platformës E-Komuna. Qytetarët do të kenë mundësi të kontribuojnë jo vetëm gjatë konsultimeve formale, por edhe në etapa të ndryshme të ciklit të politikave dhe shërbimeve — duke filluar nga identifikimi i çështjeve dhe paraqitja e propozimeve, deri te dhënia e reagimeve gjatë zbatimit dhe monitorimit të rezultateve.</p> <p>Duke mundësuar angazhim më të hershëm dhe më të qasshëm, platforma u lejon qytetarëve të ngrenë shqetësime, të propozojnë ide dhe të japin reagime para dhe gjatë vendimeve kyçe komunale. Qytetarët mund të ndjekin statusin e</p>

	<p>dorëzimeve të tyre, të ofrojnë kontribute shtesë dhe të raportojnë sfida gjatë zbatimit, duke mbështetur një ndërveprim të vazhdueshëm dhe jo vetëm konsultime njëherëshe. Informacioni publikisht në dispozicion mbi përgjigjet e komunave u mundëson qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile të monitorojnë se si merren në konsideratë dhe si zbatohen kontributet e tyre.</p> <p>Masat e synuara të informimit dhe udhëzimit për përdoruesit do të mbështesin pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse dhe do të inkurajojnë përdorimin nga grupe të ndryshme, përfshirë ata që janë më pak të njohur me mjetet digjitale. Dizajni i strukturuar i moduleve të pjesëmarrjes, i kombinuar me procedura të qarta dhe standarde për përgjigje, e shndërron pjesëmarrjen nga një aktivitet ad hoc në një praktikë të parashikueshme dhe të qasshme të qeverisjes. Me kalimin e kohës, kjo kontribuon në angazhim më të fortë qytetar dhe në vendimmarrje lokale më reaguese.</p>
--	---

Planifikimi i Zotimeve					
Pikat/etapat kyçe	Rezultatet e pritura	Data e pritur e përfundimit	Akterët		
<p><b>Dizajnimi dhe zhvillimi i moduleve të pjesëmarrjes në E-Komuna</b></p> <p>Konceptimi, dizajni teknik dhe zhvillimi i moduleve të standardizuara të pjesëmarrjes brenda platformës E-Komuna, duke përfshirë specifikimet funksionale, standardet e përdorimit dhe qasjes, si dhe masat mbrojtëse për mbrojtjen e të dhënave.</p>	<p><b>Rezultatet e pritura</b></p> <p>Modulet e pjesëmarrjes të zhvilluara dhe të integruara në platformën E-Komuna, duke mundësuar dorëzimin dhe përcjelljen e strukturuar të propozimeve, reagimeve dhe kërkesave të qytetarëve.</p> <p>Specifikat funksionale dhe teknike të miratuara, përfshirë rrjedhat e përdoruesve, kategorizimin e kontributeve dhe proceset e përgjigjeve.</p> <p>Ndërfaqet e dizajnuara në përputhje me standardet e përdorimit dhe</p>	Q 1 - 2027	Udhëheqës:		
			<u>Akterët mbështetës</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)
			<p>MAPL</p> <p>Organizatave të shoqërisë civile si bashkëzbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.</p> <p>Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj etj</p>		

	<p>qasjes.</p> <p>Masat mbrojtëse për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë të integruara në sistem.</p> <p>Karakteristika të brendshme të përcjelljes që i mundësojnë komunave të monitorojnë statusin e rasteve dhe afatet e përgjigjeve.</p>				
<p><b>Integrimi institucional dhe mbështetja për zbatimin e tij</b></p> <p>Integrimi i moduleve të pjesëmarrjes në proceset e punës së komunave përmes udhëzimeve operative, trajnimeve për stafin dhe fushatave të synuara informuese për të mbështetur përdorimin e tyre nga qytetarët.</p>	<p><b>Rezultatet e pritura</b></p> <p>Procedurat standarde operative (SOP) që përcaktojnë rolet, përgjegjësitë dhe afatet e përgjigjeve.</p> <p>Stafi komunal i trajnuar për menaxhimin e proceseve të pjesëmarrjes.</p> <p>Materiale informuese dhe udhëzues për përdoruesit që mbështesin vetëdijesimin e qytetarëve dhe përdorimin gjithëpërfshirës të platformës.</p> <p>Zbatimi fillestar në komunat pilot me dokumentimin e mësimave të nxjerra.</p>	Q	MAPL	<p>Organizatave shoqërisë civile si bashkëzbatues, si dhe organizatat tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.</p>	<p>Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj</p>
<b>Zhvillimi dhe</b>	<b>Rezultatet e</b>	Nga fundi i	Udhëheqës:		

<p><b>implementimi i moduleve për raportimin e çështjeve dhe dhënien e reagimeve</b></p> <p>Zhvillimi dhe implementimi i moduleve të standardizuara për raportimin e çështjeve dhe dhënien e reagimeve brenda platformës E-Komuna, të cilat u mundësojnë qytetarëve të raportojnë çështje lokale, të përcjellin progresin e rasteve dhe të marrin përgjigje të strukturuar. Modulet do të integrohen në proceset e punës së komunave dhe do të lidhen me standarde të përcaktuara të përgjigjeve dhe mekanizma llogaridhënieje.</p>	<p><b>pritura</b></p> <p>Modulet për raportimin e çështjeve të integruara në E-Komuna me kategori të standardizuara dhe forma të strukturuar të dorëzimit.</p> <p>Funksionaliteti i përcjelljes së rasteve që i lejon qytetarët të monitorojnë progresin nga dorëzimi deri te zgjidhja.</p> <p>Afatet e përcaktuara për përgjigje dhe standardet e shërbimit të integruara në sistem.</p> <p>Njoftime automatike që informojnë qytetarët për përditësimet e statusit dhe rezultatet.</p> <p>Proceset e brendshme të komunave që mundësojnë caktimin, menaxhimin dhe mbylljen e rasteve.</p> <p>Panele analitike të përmbledhura për komunat dhe MAPL-në për të monitoruar trendet dhe performancën.</p>	<p>vitit 2027</p>	<p><u>Akterët mbështetës</u></p>		
			<p>Qeveria</p>	<p>OSHC-të</p>	<p>Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)</p>
<p><b>Zbatimi pilot dhe testimi i funksionimit</b></p>	<p><b>Rezultatet e pritura</b></p>	<p>Q2 – 2028</p>	<p>Udhëheqës:</p>		
		<p><u>Akterët mbështetës</u></p>			
		<p>Qeveria</p>	<p>OSHC-të</p>	<p>Të tjerët</p>	

<p><b>në komunat e përzgjedhura</b></p> <p>Zbatimi pilot i moduleve të pjesëmarrjes dhe reagimeve në një grup të përzgjedhur komunash që përfaqësojnë kontekste të ndryshme administrative dhe gjeografike. Faza pilot do të testojë funksionalitetin teknik, proceset institucionale dhe përdorimin nga qytetarët, duke nxjerr (gjeneruar) dëshmi për të përmirësuar procedurat para zbatimit më të gjerë.</p>	<p>Modulet e pjesëmarrjes dhe reagimeve funksionale në komunat pilot të përzgjedhura</p> <p>Stafi komunal i trajnuar dhe i mbështetur në përdorimin e platformës, me materiale trajnimi të dokumentuara.</p> <p>Aktivitetet e informimit dhe sensibilizimit të zhvilluara në komunat pilot për të mbështetur vetëdijesimin dhe përdorimin e platformës nga qytetarët.</p> <p>Proceset operative të testuara për trajtimin e kontributeve të qytetarëve nëpër drejtoritë komunale.</p> <p>Mbledhja sistematike e reagimeve nga qytetarët dhe stafi komunal.</p> <p>Raporti i zbatimit pilot që përmbledh të dhënat e performancës, sfidat dhe përmirësimet e rekomanduara.</p>		MAPL	<p>Organizatave shoqërisë civile si bashkë-zbatues, si dhe organizatat tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.</p>	(p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)
					Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj
<b>Plani i vlerësimit dhe</b>	<b>Rezultatet e</b>	Q4 2028	Udhëheqës:		
			<u>Akterët mbështetës</u>		

<p><b>shkallëzimit</b></p> <p>Kryeni një vlerësim të bazuar në evidencën e zbatimit të pilotimit në komuna për të analizuar përdorimin, performancën institucionale dhe nivelin e adoptimit nga qytetarët. Bazuar në gjetjet, hartoni një udhërrëfyes praktik për përmirësimin e platformës dhe për zgjerimin e zbatimit në komuna të tjera.</p>	<p><b>pritura</b></p> <p>Raport publik i vlerësimit mbi përdorimin e sistemit, nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shkallën e reagimit institucional të komunës.</p> <p>Grup treguesish të performancës të nxjerra nga të dhënat pilot (p.sh., kohët e reagimit, shkallët e zgjidhjes së rasteve, trendet e përdorimit).</p> <p>Dokumentimi i mësimave të nxjerra dhe identifikimi i praktikave të mira.</p> <p>Plani i shkallëzimit me rekomandime për zgjerimin e zbatimit dhe adresimin e boshllëqeve në kapacitete.</p> <p>Shpërndarja publike e gjetjeve dhe rekomandimeve të vlerësimit.</p>		<p>Qeveria</p> <p>MAPL</p>	<p>OSHC-të</p> <p>Organizatave shoqërisë civile si bashkëzbatues, si dhe organizatat të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.</p>	<p>Të tjerët (p.sh., Parlamenti, Sektori privat etj)</p> <p>Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj</p>
--	---	--	----------------------------	--	--

## Zotimi 2: Forcimi i publikimit proaktiv dhe transparencës në Ministrinë e Financave

<b>Numri dhe Emri i Zotimit</b>	<b>Nr. 2 Forcimi i publikimit proaktiv dhe transparencës në Ministrinë e Financave</b>		
<b>Përshkrim i shkurtër i angazhimit</b>	Ky zotim krijon një mekanizëm të strukturuar tremujor monitorimi dhe përmirësimi për të siguruar publikimin e vazhdueshëm proaktiv të dokumenteve kryesore publike nga Ministria e Financave. Ai synon të forcojë transparencën institucionale, qasjen publike në informacion dhe llogaridhënien duke standardizuar praktikën e publikimit, duke përmirësuar qasjen dhe publikimin në kohë të informacionit, duke përforcuar pajtueshmërinë me detyrimet ligjore mbi publikimin proaktiv.		
<b>Institucioni udhëheqës i zotimit</b>	<b>Ministria e Financave</b>		
<b>Akterët mbështetës</b>	<b>Qeveria</b>	<b>Shoqëria Civile</b>	<b>Akterët e tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj.)</b>
	Ministria e Financave	Organizatave të shoqërisë civile si bashkë-zbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.	Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj
<b>Periudha kohore</b>	2026 – 2028		

### Përkufizimi i Problemit

#### 1. Çfarë problemi synon të adresojë zotimi?

Ky zotim trajton mungesën e një mekanizmi të rregullt dhe të strukturuar të brendshëm për monitorimin e publikimit proaktiv të dokumenteve publike nga Ministria e Financave (MF). Megjithatë detyrimet ligjore për publikim proaktiv janë në fuqi, mungesa e monitorimit sistematik ka sjellë mangësi në plotësinë, kohën e realizimit dhe qasjen në informacionet e publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë.

Ky problem ndikon tek qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, gazetarët, hulumtuesit dhe palët e tjera të interesit, të cilët mbështeten në informacion të saktë dhe të publikuar në kohë, për të kuptuar politikën, për të monitoruar shpenzimet publike, për të ushtruar të drejtat e tyre dhe për të kërkuar llogaridhënie nga institucionet. Ndikimi i tij është veçanërisht i dukshëm në fusha si ekzekutimi i buxhetit, menaxhimi i financave publike, raportimi fiskal, dhe fusha të tjera që janë në kompetencë të Ministrisë së Financave, veçanërisht gjatë cikleve buxhetore dhe rregullimeve të politikave.

Në praktikë, problemi shfaqet tek publikimi i paqëndrueshëm i dokumenteve, informacioni i vjetruar dhe dukshmëria e kufizuar e materialeve kyçe. Këto mangësi e dëmtojnë transparencën, e dobësojnë llogaridhënien dhe e ulin besimin e publikut në proceset institucionale. Kjo dukuri e cila vazhdon ndër vite tregon për një problem sistematik, i cili buron nga mungesa e proceseve formale të monitorimit për të vlerësuar përputhshmërinë dhe për të nxitur masa korrigjuese, dhe nuk ka të bëjë me raste të izoluar. Duke adresuar këtë sfidë, zotimi synon të zëvendësojë praktikën ad hoc (aty për aty) të publikimit, me një sistem të parashikueshëm, të përgjegjshëm dhe në përputhje me kërkesat ligjore për publikim proaktiv.

## **2. Cilat janë shkaqet e problemit?**

Shkaku kryesor i problemit është mungesa e një mekanizmi formal dhe të vazhdueshëm të brendshëm brenda Ministrisë së Financave (MF) për monitorimin e publikimit proaktiv të dokumenteve publike. Në praktikë, publikimi ka qenë kryesisht i varur nga praktikat individuale të njërive organizative, pa një proces të strukturuar që të vlerësojë sistematikisht kohën, përputhjen, qasjen dhe cilësinë e informacionit të publikuar në faqen e internetit të Ministrisë. Si rezultat, mangësitë në publikim nuk identifikohen apo trajtohen në mënyrë të koordinuar dhe të qëndrueshme.

Një shkak që ndërlidhet me këtë dukuri është mungesa e një cikli institucional të rregullt për raportimin dhe rishikimin e praktikave të publikimit proaktiv. Pa monitorim periodik, standarde të përbashkëta dhe reagim të strukturuar, njësitë organizative nuk kanë një bazë të qartë për të prioritetizuar veprimet korrigjuese dhe për të ruajtur përmirësimet gjatë kohës. Kjo bënë që përparimi të jetë i pjesshëm dhe i paqëndrueshëm, në vend të krijimit të një sistemi të qëndrueshëm të përmirësimit të vazhdueshëm.

Këta faktorë tregojnë për dobësi strukturore dhe procedurale, jo për probleme teknike të izoluar. Ky zotim adreson këto shkaqe themelore duke vendosur një kornizë të rregullt monitorimi tremujor, e cila krijon një cikël sistematik reagimesh dhe forcon llogaridhënien institucionale për detyrimet e publikimit proaktiv.

## **Përshkrimi i Zotimit**

### **1. Çfarë është bërë deri më tani për të zgjidhur problemin?**

Deri më tani, përpjekjet për të adresuar këtë çështje janë përqendruar kryesisht në zbatimin e detyrimeve ligjore ekzistuese për publikimin proaktiv të dokumenteve publike dhe informacionit financiar nga njësitë organizative brenda Ministrisë së Financave (MF). Praktikave të publikimit janë menaxhuar kryesisht individualisht nga njësitë përgjegjëse, pa një mekanizëm të brendshëm të strukturuar që të vlerësojë rregullisht përputhshmërinë, qëndrueshmërinë, kohën e realizimit apo cilësinë e informacionit të publikuar. Si pasojë, mangësitë në publikim nuk janë identifikuar apo trajtuar sistematikisht përmes një procesi institucional të koordinuar, dhe veprimet korrigjuese janë mbështetur kryesisht në iniciativa ad hoc.

Monitorimi i publikimit proaktiv është kryer kryesisht nga organe të jashtme mbikëqyrëse. Agjencia për Informacion dhe Privatësi ka vlerësuar përputhshmërinë me Ligjin për Qasjen në Dokumente Publike, ndërsa Zyra e Komisionerit për Gjuhët ka monitoruar publikimin në gjuhët zyrtare në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare. Këto vlerësime nga jashtë kanë rritur ndërgjegjësimin mbi detyrimet ligjore dhe kanë kontribuar në përmirësim të pjesshëm. Megjithatë, ato nuk kanë krijuar një mekanizëm të qëndrueshëm të brendshëm brenda Ministrisë në identifikimin e vazhdueshëm të mangësive dhe në përmirësimin sistematik të praktikave të publikimit proaktiv.

Ky zotim adreson këtë mungesë duke prezantuar, për herë të parë, një proces të rregullt monitorimi të brendshëm tremujor, ku publikimi proaktiv bëhet pjesë e praktikave rutinore të qeverisjes së Ministrisë.

### **2. Çfarë zgjidhjeje po propozoni?**

Zgjidhja e propozuar krijon, për herë të parë, një mekanizëm formal të brendshëm për monitorimin e rregullt tremujor të publikimit proaktiv të dokumenteve publike nga Ministria e Financave (MF). Monitorimi do të kryhet duke përdorur shabllone të standardizuara për të vlerësuar nëse dokumentet e publikuara në faqen e internetit të Ministrisë janë të plota, të qasshme dhe në dispoziicion në gjuhë të ndryshme, duke përfshirë publikimin në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Rezultatet e çdo cikli monitorimi do të përfshihen në raporte të brendshme tremujore që do të ndahen me Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm dhe njësitë organizative përkatëse. Këto raporte do të identifikojnë mangësitë, do të përcaktojnë veprimet korrigjuese dhe do të mbështesin përcjelljen e koordinuar për përmirësimin e praktikave të publikimit. Duke krijuar një cikël të parashikueshëm monitorimi dhe reagimesh, mekanizmi integron transparencën proaktive në rrjedhat rutinore institucionale.

Përmes kësaj qasje të strukturuar, zotimi forcon transparencën institucionale, rrit përgjegjësinë e njërive organizative për publikim proaktiv dhe krijon një kornizë të qëndrueshme për përmirësimin e vazhdueshëm të publikimit, qasjes dhe përditësimit të dokumenteve publike. Mekanizmi mbështet zbatimin efektiv të detyrimeve ligjore ekzistuese për publikim proaktiv sipas Ligjit për Qasjen në

## Dokumente Publike.

### 3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë duke zbatuar këtë zotim?

Zbatimi i këtij zotimi do të sjellë rezultate konkrete përmes zhvillimit dhe përdorimit sistematik të mjeteve të standardizuara për monitorimin e publikimit proaktiv të dokumenteve publike. Rezultatet kryesore përfshijnë hartimin dhe përdorimin e shablone-ve të monitorimit, përgatitjen e raporteve tremujore të monitorimit dhe organizimin e aktiviteteve të brendshme mbështetëse brenda Ministrisë së Financave (MF). Çdo raport tremujor do të vlerësojë plotësinë e dokumenteve, qasjen dhe sa janë në dispozicion në gjuhë të ndryshme dokumentet e publikuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në aspektin e kapacitetit institucional, zotimi synon të forcojë njohuritë dhe ndërgjegjësimin e drejtuesve të njësisë organizative lidhur me detyrimet për publikim proaktiv dhe identifikimin e dokumenteve që duhet të bëhen publike me iniciativë të institucionit. Për të mbështetur këtë qëllim, gjatë periudhës 2026–2028 do të organizohen dy punëtori të brendshme për të udhëzuar njësitë organizative për përdorimin e gjetjeve gjatë monitorimit dhe për përmirësimin e praktikave të publikimit.

Në nivel institucional, zotimi krijon një kornizë të strukturuar për reflektim dhe përmirësim të rregullt të praktikave të publikimit proaktiv. Monitorimi dhe raportimi tremujor do të sigurojnë një bazë të dokumentuar për marrjen e vendimeve të informuara, vetëvlerësimin institucional dhe veprimet korrigjuese të koordinuara. Ky proces kontribuon në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies institucionale, duke promovuar përputhshmëri të qëndrueshme me detyrimet ligjore për qasjen në dokumente publike.

Zbatimi i këtij zotimi do të mbështetet në kapacitetet ekzistuese njerëzore dhe institucionale të Divizionit për Transparencë. Për periudhën 2026–2028, buxheti i planifikuar i përgjithshëm për këtë zotim arrin në shumën 96,744.28 EUR, i cili mbulon zbatimin e brendshëm të mekanizmit të monitorimit dhe për dy punëtoritë e brendshme të realizuara për njësitë organizative brenda MF-së.

## Analiza e Zotimit

### 1. Si do ta promovojë transparencën zotimi?

Ky zotim promovon transparencën institucionale duke krijuar një mekanizëm të rregullt tremujor për monitorimin e publikimit proaktiv të dokumenteve publike në faqen e internetit të Ministrisë së Financave (MF). Duke përdorur shablone të standardizuara të monitorimit dhe raporte tremujore, mekanizmi siguron një përmbledhje të strukturuar dhe të dokumentuar mbi plotësinë, qasjen dhe sa janë në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze informacionet e publikuara.

Përmes vlerësimit sistematik të praktikave të publikimit, procesi i monitorimit rrit qëndrueshmërinë, parashikueshmërinë dhe përputhjen gjatë publikimit proaktiv. Ai bën të dukshme mangësitë në informacion, mbështet veprime korrigjuese në kohë dhe ndihmon në sigurimin që publiku të ketë qasje të besueshme dhe të barabartë në dokumentet publike, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

### 2. Si do të ndihmojë zotimi në nxitjen e llogaridhënies?

Ky zotim nxit llogaridhënien institucionale duke krijuar një cikël të rregullt të brendshëm të monitorimit, raportimit dhe përcjelljes së publikimit proaktiv të dokumenteve publike. Raportet tremujore të monitorimit do t'i përcillen Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe njësisë organizative përkatëse, duke krijuar një bazë të dokumentuar të mbikëqyrjes dhe veprimeve korrigjuese të koordinuara.

Duke sqaruar përgjegjësitë dhe duke dokumentuar performancën, mekanizmi bën të dukshme mangësitë brenda institucionit dhe mbështet përgjigje të shpejta aty ku identifikohen dobësitë. Përdorimi sistematik i gjetjeve të monitorimit për të rekomanduar përmirësimet forcon llogaridhënien në të gjitha njësitë organizative dhe promovon

	përputhshmëri të qëndrueshme me detyrimet për publikim proaktiv.
<b>3. Si do ta përmirësojë zotimi pjesëmarrjen e qytetarëve në përcaktimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?</b>	<p>Edhe pse ky zotim nuk krijon mekanizma të rinj për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë, ai forcon bazat për pjesëmarrjen e qytetarëve duke përmirësuar qasjen publike në informacion. Përmes përmirësimit të identifikimit, strukturimit dhe publikimit të rregullt të dokumenteve kyçe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave, zotimi krijon kushte më të mira për angazhim qytetar të informuar.</p> <p>Monitorimi sistematik siguron që dokumentet publike të jenë më të plota, të përditësuara dhe të qasshme në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Qasja e përmirësuar në informacion të besueshëm u mundëson qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe mediave të angazhohen më efektivisht në debatet publike, të monitorojnë veprimet institucionale dhe të kontribuojnë në mënyrë të informuar në diskutimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e politikave publike.</p>

Planifikimi i Zotimeve					
Pikat/etapat kyçe	Rezultatet e pritura	Data e pritur e përfundimit	Akterët		
<b>Zhvillimi i shablloneve të standardizuara të monitorimit</b>  Hartimi dhe miratimi i shablloneve të standardizuara për monitorimin tremujor të publikimit proaktiv të dokumenteve publike nga Ministria e Financave (MF) në përputhje me detyrimet ligjore në fuqi.	<b>Rezultatet e pritura</b>  Shabllonet e standardizuara të monitorimit, të miratuara zyrtarisht, që mbulojnë të gjitha kategoritë e dokumenteve që i nënshtrohen publikimit proaktiv.  Shabllonet e monitorimit të harmonizuara me Ligji për Qasje në Dokumente Publike, udhëzimet përkatëse administrative për faqet zyrtare të institucioneve, si dhe me legjislacionin sektorial financiar në fuqi.  Kategorizim i qartë i llojeve të dokumenteve,	Q 1 2026	<b>Udhëheqës: Ministria e Financave</b> Divizioni i Transparencës		
			<u>Akterët mbështetës</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)
			<b>Ministria e Financave</b>  Organizatat e shoqërisë civile si bashkëzbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.		
			Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj		

	<p>kërkesave për publikim, kritereve të qasjes dhe treguesve të përputhshmërisë gjuhësore.</p> <p>Udhëzime praktike për njësitë organizative mbi mënyrën e zbatimit të shablloneve gjatë procesit të monitorimit tremujor.</p>				
<p><b>Zbatimi i monitorimit tremujor</b></p> <p>Zbatimi i një cikli të rregullt monitorimi tremujor, duke përdorur shabllone të standardizuara, për të vlerësuar përputhshmërinë me detyrimet për publikim proaktiv në Ministrinë e Financave (MF)</p>	<p><b>Rezultatet e pritura</b></p> <p>Ushtrime të monitorimit tremujor të realizuara në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhës 2026–2028</p> <p>Shabllone të plotësuara të monitorimit që dokumentojnë statusin e publikimit të dokumenteve të kërkuara.</p> <p>Evidenca të monitorimit që specifikojnë detyrimet ligjore për publikim, për të pasur në dispozicion dokumentet dhe për të pasur përputhshmëri gjuhësore (shqip, serbisht, anglisht).</p> <p>Përditësim periodik i shablloneve të monitorimit për të reflektuar ndryshimet</p>	<p>Tremujor, gjatë periudhës <b>2026–2028</b></p>	<p>Udhëheqës: <b>Ministria e Financave</b></p>		
			<p><u>Akterët mbështetës</u></p>		
			<p>Qeveria</p>	<p>OSHC-të</p>	<p>Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)</p>
			<p><b>Ministria e Financave</b></p>	<p>Organizatave shoqërisë civile si bashkëzbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.</p>	<p>Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj</p>

	<p>legjislative apo institucionale.</p> <p>Vërejtje të dokumentuara dhe rekomandime korrigjuese të regjistruara për secilin cikël monitorimi.</p>				
<p><b>Përgatitja dhe përdorimi i raporteve tremujore monitorimit</b></p> <p>Përgatitja e raporteve të strukturuar tremujore të monitorimit, që vlerësojnë përputhshmërinë me detyrimet për publikim proaktiv dhe transparencë financiare në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave (MF).</p>	<p><b>Rezultatet e pritura</b></p> <p>Raporte tremujore të monitorimit të përgatitura dhe të finalizuara brenda dy muajve pas përfundimit të çdo tremujori raportues (2026–2028).</p> <p>Raporte që vlerësojnë përputhshmërinë me kërkesat ligjore për publikim, përfshirë të pasurit në dispozicion dokumentet, afatet kohore, qasjen, strukturën, formatin dhe mbulueshmërinë gjuhësore.</p> <p>Identifikimi i boshllëqeve në publikim, publikimet e pjesshme, si dhe mospërputhjet teknike apo gjuhësore.</p> <p>Rekomandime të dokumentuara dhe masa korrigjuese për njësitë organizative përgjegjëse.</p> <p>Shpërndarja e</p>	<p>Cikël tremujor i raportimit gjatë periudhës <b>2026–2028</b></p>	<p>Udhëheqës: <b>Ministria e Financave</b> Divizioni i Transparencës</p>		
			<p><u>Akterët mbështetës</u></p>		
			<p>Qeveria</p>	<p>OSHC-të</p>	<p>Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)</p>
			<p><b>Ministria e Financave</b> Divizioni i Transparencës</p>	<p>Organizatave shoqërisë civile si bashkëzbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.</p>	<p>Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj</p>

	brendshme e raporteve për t'i përcjellur ato dhe për t'i bërë përmirësimet në formë të koordinuar.				
<p><b>Shpërndarja dhe përdorimi institucional i raporteve tremujore të monitorimit</b></p> <p>Shpërndarja sistematike e raporteve tremujore të monitorimit tek menaxhmenti i lartë dhe njësitë organizative, me qëllim që ato të përcillen në mënyrë institucionale dhe të ndërmarren masa korrigjuese.</p>	<p><b>Rezultatet e pritura</b></p> <p>Raportet tremujore të monitorimit të dorëzuara zyrtarisht në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm dhe tek udhëheqësit e njësive organizative.</p> <p>Qarkullim i brendshëm i raporteve tek departamentet dhe divizionet përkatëse.</p> <p>Raportet e përdorura si bazë për reflektim institucional dhe për masa të koordinuara përmirësuese.</p> <p>Veprime pasuese të dokumentuara, të iniciuara nga njësitë organizative përgjegjëse.</p>	<p>Cikël tremujor i raportimit gjatë periudhës <b>2026–2028</b></p>	<p>Udhëheqës: <b>Ministria e Financave</b> Divizioni i Transparencës</p>		
			<p><u>Akterët mbështetës</u></p>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)
			<p><b>Ministria e Financave</b> Divizioni i Transparencës</p>	<p>Organizatave shoqërisë civile si bashkëzbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.</p>	<p>Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj</p>
<p><b>Organizimi i punëtorive për ndërtimin e kapaciteteve lidhur me monitorimin dhe publikimin proaktiv</b></p> <p>Organizimi i punëtorive të brendshme për të forcuar kapacitetin institucional për zbatimin e mekanizmit të monitorimit dhe</p>	<p><b>Rezultatet e pritura</b></p> <p>Dy punëtoritë brendshme të realizuara për njësitë organizative brenda MF-së.</p> <p>Materiale të punëtorive që shpjegojnë procedurat e</p>	<p>Dy punëtoritë të realizuara gjatë <b>2026–2028</b> (p.sh., <i>punëtoritë fillestare në fillim të vitit 2026 dhe punëtoritë pasuese gjatë zbatimit</i>)</p>	<p>Udhëheqës: <b>Ministria e Financave</b> Divizioni i Transparencës</p>		
			<p><u>Akterët mbështetës</u></p>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerët (p.sh., Parlament i, AKK, Sektori privat etj)
			<p><b>Ministria e Financave</b> Divizioni i</p>	<p>Organizatave shoqërisë civile si bashkë-</p>	<p>Agency for Information and Privacy</p>

përmirësimin e praktikave të publikimit proaktiv.	<p>monitorimit dhe detyrimet ligjore për publikimin proaktiv.</p> <p>Rritje e vetëdijes mbi përgjegjësitë lidhur me publikimin e dokumenteve dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese.</p> <p>Mbledhje e komenteve dhe sugjerimeve nga njësitë organizative për të informuar përmirësimet e ardhshme.</p>		Transparencës	zbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.	
---	---	--	---------------	--	--

### Zotimi 3: Standardizimi dhe përmirësimi i publikimit proaktiv të dokumenteve publike dhe monitorimi i platformës së të dhënave të hapura

<b>Numri dhe Emri i Zotimit</b>	<b>Nr. 3 Standardizimi dhe përmirësimi i publikimit proaktiv të dokumenteve publike dhe monitorimi i platformës së të dhënave të hapura</b>
<b>Përshkrim i shkurtër i angazhimit</b>	<p>Ky zotim vendos kërkesa të standardizuara për publikimin proaktiv të informatave të qarta, të plota dhe të kuptueshme për shërbimet publike. I pilotuar në institucione të përzgjedhura publike, ai synon të përmirësojë transparencën, qasjen e qytetarëve në informatat për shërbimet dhe konsistencën në mënyrën se si institucionet komunikojnë shërbimet e disponueshme dhe publikimin e dokumenteve. Nisma do të zhvillojë modele të përbashkëta dhe udhëzime për publikimin e përshkrimeve të shërbimeve, kritereve të përfitimit, procedurave, afateve dhe informacioneve të kontaktit, duke krijuar një mjedis më të qasshëm dhe më të orientuar drejt qytetarëve.</p> <p>Standardizimi dhe përmirësimi i publikimit proaktiv të dokumenteve publike siguron që qytetarët të kenë qasje të lehtë dhe të drejtpërdrejtë në informatat mbi aktivitetet e institucioneve publike. Kjo rrit transparencën dhe u mundëson qytetarëve të monitorojnë përdorimin e fondeve publike, vendimet qeveritare dhe zbatimin e politikave publike. Publikimi i qartë dhe i harmonizuar i dokumenteve gjithashtu forcon llogaridhënien institucionale ndaj publikut.</p> <p>Monitorimi i platformës së të dhënave të hapura siguron që informacionet e</p>

	publikuara të jenë të përditësuara, të sakta dhe të qasshme për të gjithë. Kjo promovon qasjen e hapur në informacion, inkurajon pjesëmarrjen qytetare dhe krijon mundësi për inovacion në përdorimin e të dhënave, duke mbështetur zhvillimin e aplikacioneve, analizave dhe projekteve të bazuara në informata publike. Në fund, ky proces rrit besimin e qytetarëve në institucione dhe kontribuon në një qeverisje më transparente dhe më efektive.		
<b>Institucioni udhëheqës i zotimit</b>	<b>Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP)</b>		
<b>Akterët mbështetës</b>	<b>Qeveria</b>	<b>Shoqëria Civile</b>	<b>Akterët tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)</b>
	Komunat, AIP, ministritë e linjës	Organizatat e shoqërisë civile si bashkë-zbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.	<b>Asociacioni i Komunave të Kosovës</b>
<b>Periudha kohore</b>	<b>2026 - 2028</b>		

### Përkufizimi i Problemit

#### 1. Çfarë problemi synon të adresojë zotimi?

Ky zotim synon të adresojë mungesën e publikimit proaktiv, të qartë dhe të standardizuar të informacioneve nga institucionet publike në Kosovë, veçanërisht informacionin që lidhet me shërbimet publike. Ky hendek ndikon drejtpërdrejt tek qytetarët dhe në të njëjtën kohë dëmton transparencën institucionale dhe ofrimin efektiv të shërbimeve publike.

Qytetarët në të gjithë Kosovën, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal, preken nga ky problem, veçanërisht kur kanë nevojë të qasen në shërbime administrative ose të ushtrojnë të drejtat e tyre ligjore. Në shumë raste, qytetarët nuk kanë qasje në informacione thelbësore se si të marrin një shërbim, duke përfshirë kriteret e përfitimit, dokumentacionin e kërkuar, kostot, afatet dhe mekanizmat e ankesës.

Edhe në rastet kur informacioni është i disponueshëm, ai shpesh është i fragmentuar, i vjetëruar ose i paraqitur në një mënyrë që nuk është miqësore për përdoruesit, duke e bërë të vështirë për qytetarët ta kuptojnë dhe ta përdorin atë.

## **2. Cilat janë shkaqet e problemit?**

Mungesa e publikimit proaktiv, të saktë dhe të standardizuar të informacioneve nga institucionet publike në Kosovë — veçanërisht sa i përket shërbimeve publike për qytetarët — mbetet një sfidë e vazhdueshme me ndikim të drejtpërdrejtë në transparencën institucionale dhe në ushtrimin efektiv të të drejtave të qytetarëve.

Në shumë raste, institucionet publike nuk publikojnë informacione të plota dhe të qarta mbi procedurat administrative, kriteret e përfitimit, dokumentacionin e kërkuar, kostot, afatet ligjore dhe mekanizmat e ankesës që lidhen me shërbimet publike. Ky problem prek qytetarët në të gjithë Kosovën, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal, veçanërisht gjatë ndërveprimit të tyre të përditshëm me administratën publike kur aplikojnë për shërbime administrative ose kur ushtrojnë të drejtat e tyre ligjore.

Qytetarët preken më së shumti në fazën e aplikimit për shërbime, ku mungesa e informacionit të qartë, të strukturuar dhe të qasshëm krijon pasiguri, konfuzion dhe vonesa procedurale. Edhe në rastet kur informacioni për shërbimet publike publikohet, ai shpesh është i fragmentuar, i vjetëruar ose i paraqitur në një mënyrë që nuk është e qartë apo miqësore për përdoruesit.

Për shembull, në faqet zyrtare të institucioneve ose në platformën e-Kosova, disa shërbime ofrojnë vetëm formularë aplikimi ose mundësi për dorëzim online, ndërsa mungojnë informacione thelbësore shoqëruese, si procedurat hap-pas-hapi, afatet ligjore të detyrueshme për përgjigje, kostot e shërbimit apo procedurat e ankesës në rast refuzimi ose mosofrimi të shërbimit brenda afatit ligjor. Kjo kufizon ndjeshëm mundësinë e qytetarëve për të kuptuar dhe përdorur në mënyrë efektive shërbimet e disponueshme dhe njëkohësisht dobëson përfitimet e synuara të procesit të digjitalizimit.

## **Përshkrimi i Zotimit**

### **1. Çfarë është bërë deri më tani për ta zgjidhur problemin?**

Në vitet e fundit, institucionet publike në Kosovë kanë ndërmarrë iniciativa të ndryshme për të përmirësuar transparencën dhe qasjen në informacion publik, kryesisht përmes publikimit proaktiv të dokumenteve në përputhje me obligimet ligjore që rrjedhin nga Ligji për Qasje në Dokumente Publike. Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) ka luajtur një rol kyç në monitorimin e zbatimit të këtij ligji dhe në promovimin e praktikave të publikimit proaktiv nëpër institucione.

Paralelisht, digjitalizimi i shërbimeve publike — veçanërisht përmes faqeve zyrtare të institucioneve dhe platformës e-Kosova — ka kontribuar në rritjen e disponueshmërisë së shërbimeve online dhe mekanizmave për aplikim elektronik. Ministri të veçanta dhe komuna kanë ndërmarrë gjithashtu iniciativa të veçuara për publikimin e informatave që lidhen me shërbimet brenda mandatit të tyre institucional.

Megjithatë, këto përpjekje kanë qenë kryesisht të fragmentuara dhe të pabarabarta ndërmjet institucioneve. Edhe pse qasja teknike në shërbime është përmirësuar, publikimi i informatave gjithëpërfshirëse, të standardizuara dhe miqësore për përdoruesit lidhur me procedurat e shërbimeve, kërkesat, kostot, afatet dhe mekanizmat e ankesës ka mbetur i paqëndrueshëm. Si rezultat, zgjidhjet e deritanishme e kanë adresuar problemin vetëm pjesërisht dhe nuk kanë arritur të krijojnë një qasje të unifikuar dhe të orientuar drejt qytetarit për publikimin proaktiv të informatave që lidhen me shërbimet publike.

## 2. Çfarë zgjidhjeje po propozoni?

Ky zotim propozon një qasje të strukturuar dhe të standardizuar për publikimin proaktiv të informatave të plota dhe miqësore për përdoruesit lidhur me shërbimet publike, me fokus të veçantë në nevojat e qytetarëve. Zotimi do ta pilotojë këtë qasje në pesë institucione publike — tre komuna dhe dy ministri — të cilat do të shërbejnë si terren testues për një model të unifikuar që mund të replikohet në të gjithë sektorin publik.

Pilotimi do të fokusohet në sigurimin që, për secilin shërbim publik të përzgjedhur, institucionet të publikojnë në mënyrë proaktive informacionet thelbësore në përputhje me **Ligjin për Qasje në Dokumente Publike**. Kjo përfshin procedurat e shërbimit dhe kriteret e përfitimit; dokumentacionin e kërkuar dhe kostot; formularët e aplikimit dhe udhëzimet për përdoruesit; afatet ligjore të detyrueshme për ofrimin e shërbimit; si dhe procedurat e ankesës dhe autoritetet përgjegjëse.

Kjo qasje dallon nga përpjekjet e mëparshme duke kaluar nga iniciativa të veçuara dhe specifike për institucione të caktuara drejt një modeli të standardizuar dhe të orientuar në shërbime, i cili priorizon qartësinë, përdorshmërinë dhe plotësinë ligjore të informacionit.

Megjithëse ky zotim nuk do t'i zgjidhë plotësisht të gjitha sfidat që lidhen me transparencën e shërbimeve publike, ai do të adresojë një pjesë të konsiderueshme të problemit duke përmirësuar cilësinë, konsistencën dhe qasshmërinë e informacionit për shërbimet e përzgjedhura. Pilotimi do të ofrojë dëshmi dhe përvojë praktike për të mbështetur zgjerimin gradual të këtij modeli në institucione dhe shërbime të tjera.

## 3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë duke zbatuar këtë zotim?

Ky zotim do të rrisë transparencën duke siguruar që institucionet publike në Kosovë të publikojnë rregullisht, në mënyrë të qartë dhe në kohë, informacionet dhe të dhënat kyçe, pa qenë e nevojshme që qytetarët të paraqesin kërkesa formale për qasje në informacion.

Informacionet e publikuara mund të përfshijnë vendime, raporte, buxhete, kontrata, përditësime mbi zbatimin e politikave dhe dokumente të tjera relevante. Kjo do të përmirësojë qasjen e qytetarëve në informacion duke i bërë të dhënat të disponueshme online në formate të hapura dhe të lehta për t'u kuptuar.

Si rezultat, qytetarët do të kenë një kuptim më të mirë për mënyrën se si funksionojnë institucionet publike, si merren vendimet dhe si përdoren resurset publike, duke forcuar kështu transparencën në qeverisje.

### Analiza e Zotimit

Pyetjet	Përgjigje (nëse nuk është e aplikueshme, përgjigjuni vetëm me N/A)
1. Si do ta promovojë transparencën zotimi?	<p>Rritja e transparencës institucionale përmes publikimit proaktiv, të saktë dhe të standardizuar të informacionit për shërbimet ndaj qytetarëve, në përputhje me <b>Ligjin për Qasje në Dokumente Publike</b>.</p> <p>Përmirësimi i qasjes së qytetarëve në informacione të qarta dhe të kuptueshme mbi procedurat, kushtet, dokumentacionin e nevojshëm, kostot, afatet ligjore dhe mekanizmat e ankesës për shërbimet publike, duke reduktuar pasigurinë dhe konfuzionin gjatë përfitimit të shërbimeve.</p>

<p><b>2. Si do të ndihmojë zotimi në nxitjen e llogaridhënies?</b></p>	<p>Ky zotim do të rrisë llogaridhënien duke kërkuar që institucionet publike të publikojnë informacione mbi aktivitetet e tyre, përgjegjësitë dhe progresin në zbatimin e politikave dhe zotimeve. Kur informacioni është i hapur për publikun, institucionet bëhen më të përgjegjshme për veprimet dhe vendimet e tyre.</p> <p>Publikimi proaktiv do t'u mundësojë qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe mediave të ndjekin progresin dhe të identifikojnë vonesat apo mangësitë në zbatimin e politikave dhe aktiviteteve institucionale.</p>
<p><b>3. Si do ta përmirësojë zotimi pjesëmarrjen e qytetarëve në përcaktimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?</b></p>	<p>Kur informacionet dhe dokumentet publikohen në mënyrë proaktive, qytetarët kanë mundësi më të mirë të kuptojnë çështjet publike, të propozojnë zgjidhje dhe të marrin pjesë në mënyrë domethënëse në konsultimet publike.</p> <p>Ky zotim do të angazhojë qytetarët dhe grupet e tyre përmes vendosjes së mekanizmave për reagime (feedback), konsultime publike dhe bashkëpunim me shoqërinë civile lidhur me informacionet e publikuara. Po ashtu, ai do të mbështesë monitorimin qytetar duke u mundësuar individëve dhe grupeve të ndjekin progresin, të vlerësojnë rezultatet dhe të kontribuojnë në mbikëqytjen e proceseve.</p> <p>Kjo forcon besimin e publikut në institucione dhe inkurajon një pjesëmarrje më aktive të qytetarëve në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike në Kosovë.</p>

<b>Planifikimi i Zotimeve</b> <i>(Ky është një proces fillestar planifikimi që fokusohet kryesisht në përcaktimin e pikave kyçe të realizimit dhe rezultateve të pritshme, si dhe në identifikimin e palëve kryesore të përfshira.)</i>												
Pikat/etapat kyçe	Rezultatet e pritura	Data e pritur e përfundimit	Akterët									
<p><b>Përzgjedhja e institucioneve pilot dhe vlerësimi bazë</b></p> <p>Përzgjedhja e pilot institucioneve dhe vlerësimi i praktikave ekzistuese për publikimin e informacionit mbi shërbimet publike.</p>	<p><b>Rezultatet e pritura</b></p> <p>Monitorimi i publikimit proaktiv të dokumenteve dhe informacioneve.</p> <p>Konfirmimi zyrtar i pesë institucioneve pilote (tre komuna dhe dy ministri).</p> <p>Inventari i dokumenteve publike i ofruar nga secili institucion pilot.</p>	<p>Q2 2026</p>	<p>Udhëheqës: <b>Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP)</b></p> <table border="1" data-bbox="949 1464 1410 2033"> <thead> <tr> <th colspan="3" data-bbox="949 1464 1410 1503"><u>Akterët mbështetës</u></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="949 1503 1126 1666">Qeveria</td> <td data-bbox="1126 1503 1278 1666">OSHC-të</td> <td data-bbox="1278 1503 1410 1666">Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)</td> </tr> <tr> <td data-bbox="949 1666 1126 2033"><b>Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), ministrinë e përzgjedhur</b></td> <td data-bbox="1126 1666 1278 2033">Organizatave të shoqërisë civile si bashkëzbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës</td> <td data-bbox="1278 1666 1410 2033">Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj</td> </tr> </tbody> </table>	<u>Akterët mbështetës</u>			Qeveria	OSHC-të	Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)	<b>Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), ministrinë e përzgjedhur</b>	Organizatave të shoqërisë civile si bashkëzbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës	Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj
			<u>Akterët mbështetës</u>									
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)							
<b>Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), ministrinë e përzgjedhur</b>	Organizatave të shoqërisë civile si bashkëzbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës	Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj										

	<p>Raporti i vlerësimit fillestar (baseline) që vlerëson disponueshmërinë, qartësinë dhe qasshmërinë e dokumenteve dhe informacioneve publike.</p> <p>Marrëveshje bashkëpunimi ose memorandum bashkëpunimi të nënshkruar me secilin institucion pilot.</p>			<p>hirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.</p>	
<p><b>Zhvillimi i një shablloni dhe udhëzuesi të standardizuar për publikimin e informacionit të shërbimit publik</b></p> <p>Hartimi dhe miratimi i një shablloni të standardizuar dhe udhëzimeve praktike për publikimin proaktiv të informacionit të shërbimit publik, në përputhje me detyrimet ligjore për qasjen në dokumente publike.</p>	<p><b>Rezultatet e pritura</b></p> <p>Shabllon i standardizuar i miratuar zyrtarisht për publikimin e informacionit mbi shërbimet publike.</p> <p>Shabllon që mbulon elementet kryesore si përshkrimin e shërbimit, kriteret e përfitueshmërisë, procedurat, dokumentet e kërkuara, afatet kohore, tarifat dhe informatat rreth kontaktit.</p> <p>Dokument udhëzues praktik që shpjegon mënyrën se si institucionet duhet ta zbatojnë shabllonin.</p> <p>Miratimi i shabllonit përmes konsultimit me pilot institucionet.</p> <p>Versioni përfundimtar i</p>	2027	<p>Udhëheqës: <b>Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP)</b></p>		
			<p><u>Akterët mbështetës</u></p>		
			<p>Qeveria</p>	<p>OSHC-të</p>	<p>Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)</p>
			<p><b>Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP)</b></p>	<p>Organizatata e shoqërisë civile si bashkëzbatues, si dhe organizatat të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të hirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.</p>	<p>Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj</p>

	shabllonit dhe udhëzuesit i gatshëm për zbatim në fazën pilot.				
<p><b>Ndërtimi i kapaciteteve dhe përgatitja institucionale për zbatim</b></p> <p>Forcimi i kapaciteteve institucionale në pilot institucionet për zbatimin e publikimit të standardizuar të informacionit mbi shërbimet publike.</p>	<p><b>Rezultatet e pritura</b></p> <p>Të paktën pesë punëtori trajnuese të realizuara për zyrtarët përgjegjës për informim publik dhe komunikim.</p> <p>Rreth 100 zyrtarë publikë të trajnuar për zbatimin e shabllonit të standardizuar të publikimit.</p> <p>Caktimi i personit kontaktues për publikimin e informacionit mbi shërbimet në secilin pilot institucion.</p> <p>Plane institucionale veprimi të hartuara për të udhëhequr zbatimin dhe përditësimin e informacionit mbi shërbimet.</p> <p>Procese të brendshme të punës të vendosura për të mbështetur rishikimin dhe përditësimin e rregullt të informacionit të publikuar.</p>	2027	Udhëheqës: <b>Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP)</b>		
			<u>Akterët mbështetës</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)
	<b>Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP)</b>	Organizatave shoqërisë civile si bashkë-zbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.	Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj		

## Zotimi 4: Rritja e transparencës dhe mbikëqyrjes publike të të dhënave kundër korrupsionit

<b>Numri dhe Emri i Zotimit</b>	<b>Nr. 4 Rritja e transparencës dhe mbikëqyrjes publike të të dhënave kundër korrupsionit</b>		
<b>Përshkrim i shkurtër i angazhimit</b>	Forcimi i integritetit publik duke përmirësuar menaxhimin digjital dhe publikimin proaktiv të të dhënave që lidhen me integritetin, përfshirë deklaratimet e pasurisë, konfliktet e interesit dhe monitorimin e planeve të integritetit. Ky angazhim synon të sigurojë qasje më të strukturuar dhe më të lehtë në këto informacione, në mënyrë që të rritet transparenca, llogaridhënia dhe mbikëqyrja nga publiku.		
<b>Institucioni udhëheqës i zotimit</b>	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK)		
<b>Akterët mbështetës</b>	<b>Qeveria</b>	<b>Shoqëria Civile</b>	<b>Akterët tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)</b>
	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK)	Organizatat e shoqërisë civile si bashkë-zbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.	Asociacioni i Komunave të Kosovës, Donatorët etj.
<b>Periudha kohore</b>	2026-2028		

### Përkufizimi i Problemit

#### 1. Çfarë problemi synon të adresojë zotimi?

Ky zotim adreson mungesën e një sistemi të standardizuar dhe lehtësisht të monitorueshëm për publikimin dhe menaxhimin e të dhënave që lidhen me integritetin në Kosovë. Në tri fusha kyçe të integritetit publik, informacioni aktualisht është i fragmentuar (i mangët), i strukturuar në mënyrë jo të njëtrajtshme dhe shpesh nuk publikohet në formate të qasshme apo të ripërdorshme, tek: deklaratimet e pasurisë dhe dhuratave, konfliktet e interesit dhe në planet institucionale të integritetit. Si pasojë, është e vështirë të krahasohen të dhënat ndër vite, të kryhen analiza sistematike apo të monitorohet performanca institucionale.

Kjo situatë kufizon transparencën kuptimplote dhe dobëson mbikëqyrjen publike. Qytetarët dhe taksapaguesit preken drejtpërdrejt, pasi mungesa e dukshmërisë mbi mekanizmat e integritetit rrit rrezikun e keqpërdorimit të burimeve publike dhe ndikimit të padrejtë në vendimmarrje. Organizatat e shoqërisë civile, gazetarët hulumtues dhe studiuesit përballen me pengesa shtesë për shkak të të dhënave të shpërndara dhe jo të standardizuara, gjë që kufizon monitorimin e bazuar në evidencë dhe identifikimin e hershëm të rreziqeve të integritetit. Edhe vetë institucionet publike preken nga kjo situatë. Në mungesë të sistemeve të integruara digjitale dhe indikatorëve të qartë të performancës, planet e integritetit shpesh mbeten dokumente formale, në vend që të shërbejnë si mjete efektive menaxhimi. Po ashtu, proceset për trajtimin e konflikteve të interesit nuk ofrojnë gjurmueshmëri të mjaftueshme për

publikun.

Problemi shfaqet në nivel kombëtar dhe prek si institucionet qendrore ashtu edhe ato lokale. Ai bëhet më i dukshëm gjatë periudhave me rrezik të shtuar për integritetin, siç janë zgjedhjet, investimet e mëdha publike, proceset e prokurimit dhe emërimet në pozita të larta. Këto sfida kanë vazhduar ndër vite për shkak të praktikave jo-sistimore të publikimit të të dhënave, mungesës së formateve të hapura dhe të ripërdorshme, si dhe mekanizmave të kufizuar digjital për monitorim të vazhdueshëm. Me kalimin e kohës, kjo ka dobësuar besimin publik në sistemet e integritetit dhe ndikuar në zbatim të pabarabartë të masave kundër korrupsionit nëpër institucione.

## 2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Problemi buron nga një kombinim faktorësh rregullator, institucional, teknik dhe organizativ, të cilët kufizojnë përdorshmërinë e të dhënave që lidhen me integritetin për mbikëqyrje efektive. Çështja kryesore nuk është mungesa e të dhënave, por fakti që informacioni ekzistues mbi deklaratimet e pasurisë, konfliktet e interesit dhe planet e integritetit nuk është i strukturuar në një mënyrë që mbështet transparencën dhe llogaridhënien kuptimplote.

Disa shkaqe themelore kontribuojnë në këtë situatë:

- **Standardet e pamjaftueshme rregullative** – Rregullat ekzistuese nuk kërkojnë në mënyrë të qëndrueshme publikimin e të dhënave të integritetit në formate të hapura, të standardizuara dhe të lexueshme nga kompjuteri, si dhe nuk përcaktojnë standarde të unifikuara për metadat apo kërkesa të rregullta për përditësim.
- **Kapacitetet e kufizuara institucionale** – Institucionet publike shpesh nuk kanë ekspertizë të specializuar në menaxhimin e të dhënave, kontrollin e cilësisë dhe analizën e rezeqeve të integritetit, gjë që ndikon në saktësinë, qëndrueshmërinë dhe dobinë e informacionit të publikuar.
- **Proceset e punës jo të standardizuara** – Proceset e raportimit, verifikimit, publikimit dhe përcjelljes nuk janë të integruara në një kornizë të unifikuar operacionale, duke rezultuar në praktika të fragmentuara dhe jo të njëtrajtshme.
- **Sistemet digjitale të fragmentuara** – Me mjetet teknologjike ekzistuese nuk është e mundur të ndërveprohet mjaftueshëm, andaj kjo ndikon që proceset e monitorimit të jenë kryesisht manuale, të ngadalta dhe të vështira për t'u zgjeruar.
- **Kultura e pajtueshmërisë formale** – Publikimi i të dhënave shpesh trajtohet si një detyrim minimal ligjor, dhe jo si një mjet funksional për analizë, mbikëqyrje dhe vendimmarrje.

Së bashku, këta faktorë rezultojnë në të dhëna për integritetin që janë të vështira për t'u kërkuar, krahasuar dhe analizuar, duke kufizuar përdorimin e tyre për mbikëqyrje publike dhe llogaridhënie institucionale.

## Përshkrimi i Angazhimit

### 1. Çfarë është bërë deri më tani për ta zgjidhur problemin?

Në vitet e fundit, Kosova ka ndërmarrë disa hapa fillestarë të rëndësishëm për digjitalizimin e aspekteve të kornizës së saj kundër korrupsionit. Është zhvilluar një platformë digjitale për deklarimin e pasurisë, e cila përfshin module për dorëzimin e deklaratimeve të pasurisë dhe dhuratave, raportimin mbi zbatimin e planeve institucionale të integritetit dhe përgatitjen e raporteve vjetore të integritetit. Këto përpjekje kanë krijuar një infrastrukturë bazë digjitale dhe kanë përmirësuar proceset e brendshme administrative që lidhen me menaxhimin e integritetit.

Megjithatë, përdorimi i të dhënave publike që lidhen me integritetin dhe qasja në ato, ka mbetur e kufizuar. Publikimi i të dhënave nuk ka qenë në mënyrë të qëndrueshme proaktiv apo i standardizuar, dhe informacioni shpesh publikohet në formate që janë të vështira për t'u kërkuar, krahasuar apo ripërdorur. Për më tepër, mungesa e sistemeve të integruara dhe e indikatorëve të matshëm të performancës ka kufizuar mundësinë për të monitoruar trendet dhe për të vlerësuar efektivitetin e mekanizmave të integritetit.

Si rezultat, përpjekjet e deritanishme kanë forcuar digjitalizimin administrativ, por ende nuk kanë krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse për qasje të strukturuar publike, analizë dhe mbikëqyrje të të dhënave të integritetit. Zotimi i propozuar ndërtohet mbi platformën ekzistuese duke u fokusuar në përmirësimin e transparencës, përmirësimin e përdorimit dhe atë të ndërveprueshmërisë së të dhënave.

## **2. Çfarë zgjidhjeje po propozoni?**

Ky zotim propozon përmirësime të synuara në menaxhimin digjital dhe publikimin proaktiv të të dhënave që lidhen me integritetin. Ai fokusohet në avancimin e platformës ekzistuese të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, zhvillimin e qasjes së strukturuar publike në të dhënat kryesore përmes një API publike ose formateve të shkarkueshme, si dhe në standardizimin e publikimit të informacionit mbi deklaratimet e pasurisë, konfliktet e interesit dhe monitorimin e planeve të integritetit.

Ndryshe nga përpjekjet e mëparshme, të cilat kryesisht kanë forcuar digjitalizimin e brendshëm administrativ, zgjidhja e propozuar i jep prioritet të dhënave publike të strukturuar, të ripërdorshme dhe të krahasueshme. Ajo prezanton standarde të përbashkëta publikimi, indikatorë të matshëm dhe praktika të rregullta monitorimi, duke e bërë informacionin për integritetin më të lehtë për t'u qasur, analizuar dhe ndjekur ndër vite.

Duke përmirësuar përdorimin dhe transparencën e të dhënave, ky zotim forcon mbikëqyrjen publike dhe llogaridhënien institucionale. Ai adreson një pjesë thelbësore të problemit — mungesën e të dhënave të integritetit që janë të qasshme dhe të monitorueshme — duke pranuar njëkohësisht se reformat më të gjera kundër korrupsionit shtrihen përtej transparencës digjitale. Prandaj, zotimi përqendrohet në mënyrë specifike në dimensionin e qeverisjes digjitale dhe publikimin e të dhënave në fushën e integritetit publik.

## **3. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë duke zbatuar këtë zotim?**

Zbatimi i këtij zotimi synon të sjellë përmirësime konkrete në qasjen, përdorimin dhe monitorimin e të dhënave që lidhen me integritetin, duke forcuar kështu transparencën dhe llogaridhënien publike.

### **Rezultatet e pritura**

- Një platformë digjitale e avancuar e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me funksionalitete të përmirësuara për menaxhimin dhe publikimin e të dhënave që lidhen me integritetin;
- Qasje e strukturuar publike në të dhënat kryesore mbi deklaratimet e pasurisë, konfliktet e interesit dhe zbatimin e planeve të integritetit, përmes një API publike dhe/ose formateve të standardizuara të shkarkueshme;
- Raporte dhe sete të dhënash të publikuara rregullisht, duke përdorur standarde të përbashkëta dhe indikatorë të matshëm;
- Udhëzime dhe procedura të qarta për publikimin proaktiv dhe monitorimin e rregullt të të dhënave të integritetit.

### **Ndryshimet në njohuri, kapacitete dhe praktika**

- Forcimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e të dhënave, kontrollin e cilësisë dhe transparencën digjitale brenda institucioneve përgjegjëse publike;
- Rritja e aftësisë së shoqërisë civile, mediave dhe studiuesve për të analizuar të dhënat e integritetit dhe për të zhvilluar mbikëqyrje të bazuar në evidence;
- Vendosje e praktikave të rregullta për publikim proaktiv dhe monitorim sistematik të informacionit mbi integritetin;
- Përdorim më i gjerë i të dhënave të strukturuar për të mbështetur transparencën, analizën e reziqeve dhe vendimmarrjen e bazuar në evidence.

Këto rezultate, së bashku do të përmirësojnë funksionimin praktik të mekanizmave të integritetit, duke e bërë informacionin më të qasshëm, më të krahasueshëm dhe më të përdorshëm si për institucionet ashtu edhe për publikun.

Analiza e Zotimit	
Pyetjet	Përgjigje (nëse nuk është e aplikueshme, përgjigjuni vetëm me N/A)
1. Si do ta promovojë transparencën zotimi?	<p>Ky zotim promovon transparencën duke siguruar publikimin proaktiv të të dhënave të strukturuar, të standardizuara dhe të ripërdorshme mbi deklaratimet e pasurisë, konfliktet e interesit dhe zbatimin e planeve të integritetit. Duke përmirësuar mënyrën se si informacioni që lidhet me integritetin organizohet dhe publikohet përmes platformës digjitale të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, zotimi i bënë të dhënat kyçe publike më të lehta për t'u qasur, kërkuar dhe krahasuar.</p> <p>Zbatimit të qasjes publike përmes një API-je dhe raporteve të standardizuara të hapura përmirëson mundësinë e qytetarëve për të marrë informacion të saktë dhe në kohë. Organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe studiuesit do të jenë në gjendje të analizojnë në mënyrë më efektive të dhënat e integritetit, ndërsa publiku i gjerë do të përfitojë nga një pasqyrë më e qartë mbi mënyrën se si funksionojnë në praktikë mekanizmat e integritetit.</p> <p>Duke kaluar nga publikimi i fragmentuar dhe i bazuar në dokumente drejt publikimit të të dhënave të strukturuar dhe të përditësuara rregullisht, ky zotim rrit transparencën e institucioneve publike dhe forcon mbikëqyrjen publike mbi proceset që lidhen me integritetin.</p>
2. Si do të ndihmojë zotimi në nxitjen e llogaridhënies?	<p>Ky zotim forcon llogaridhënien duke krijuar informacion të rregullt, të standardizuar dhe të qasshëm publikisht mbi zbatimin e mekanizmave kyç të integritetit. Përmes publikimit të strukturuar të të dhënave dhe raporteve mbi deklaratimet e pasurisë, konfliktet e interesit dhe planet e integritetit, institucionet publike bëhen më të dukshme dhe më të monitorueshme nga qytetarët.</p> <p>Qasja publike në të dhënat e integritetit përmes platformave digjitale dhe formateve të hapura u mundëson shoqërisë civile, mediave dhe qytetarëve të ndjekin trendet, të krahasojnë informacionin ndër vite dhe të vlerësojnë nëse institucionet po i përmbushin detyrimet e tyre në fushën e integritetit. Përdorimi i indikatorëve të matshëm dhe raportimi i rregullt krijojnë një bazë transparente për monitorimin e performancës dhe identifikimin e mangësive.</p> <p>Ky zotim mbështet mbikëqyrjen e bazuar në evidencë dhe përforcon përgjegjësinë institucionale për t'iu përgjigjur mangësive të identifikuar, duke forcuar kështu llogaridhënien publike, dhe duke bërë që informacioni që lidhet me integritetin të jetë në dispozicion dhe të jetë i krahasueshëm në mënyrë të vazhdueshme.</p>
3. Si do ta përmirësojë zotimi pjesëmarrjen e qytetarëve në përcaktimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?	<p>Ky zotim përmirëson pjesëmarrjen qytetare duke zgjeruar qasjen e hapur në të dhëna të strukturuar mbi integritetin, të cilat qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe media mund t'i përdorin për të monitoruar performancën institucionale dhe për të kontribuar në debatin publik. Duke e bërë informacionin që lidhet me integritetin më të lehtë për t'u qasur dhe analizuar, zotimi u mundëson akterëve qytetarë të përfshihen më aktivisht në mbikëqyrje, avokim dhe dialog të bazuar në fakte me institucionet publike.</p> <p>Qasja digjitale në të dhëna të krahasueshme dhe të përditësuara rregullisht mbështet diskutimin e informuar publik mbi rreziqet e integritetit dhe prioritetet për reforma. Organizatat e shoqërisë civile</p>

	<p>dhe studiuesit mund t'i përdorin këto të dhëna për të hartuar analiza dhe rekomandime, ndërsa qytetarët fitojnë një pasqyrë më të qartë mbi mënyrën se si funksionojnë mekanizmat e integritetit në praktikë.</p> <p>Edhe pse angazhimi fokusohet kryesisht në transparencë dhe qasje në të dhëna, ai krijon baza më të forta për një angazhim kuptimplotë qytetar, duke i pajisur palët e interesit me informacion të besueshëm për të marrë pjesë në monitorimin dhe për të përmirësuar sistemet e integritetit.</p>
--	---

Planifikimi i Zotimeve					
Pikat/etapat kyçe	Rezultatet e pritura	Data e pritur e përfundimit	Akterët		
<p><b>Hartimi dhe miratimi i legjislacionit dytësor që përcakton standardet për publikimin digjital të të dhënave të integritetit</b></p> <p>Hartimi, konsultimi dhe miratimi i legjislacionit dytësor që përcakton standardet ligjore dhe teknike për publikimin digjital të strukturuar të të dhënave që lidhen me integritetin. Rregullorja do të qartësojë përgjegjësitë institucionale, formatet e publikimit të të dhënave, frekuencën e përditësimit, si dhe standardet minimale të transparencës për deklarim të pasurisë, konfliktet e interesit dhe raportimin mbi planet e integritetit.</p>	<p>Hartimi i legjislacionit dytësor që përcakton standardet për publikimin e strukturuar të të dhënave mbi integritetin</p> <p>Zhvillimi i konsultimeve me palët e interesit, përfshirë institucionet përkatëse dhe organizatat e shoqërisë civile</p> <p>Miratimi përfundimtar i legjislacionit dytësor</p> <p>Publikimi i udhëzuesit për zbatim, për institucionet përgjegjëse</p>	Q4 2026	Udhëheqës: Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK)		
			Akterët mbështetës		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)
			<p>Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK)</p> <p>Organizatave shoqërisë civile si bashkëzbatues, si dhe organizatat të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.</p> <p>Asociacioni i Komunave të Kosovës, Donatoret etj.</p>		
<p><b>Zhvillimi dhe funksionalizimi i qasjes publike digjitale në të dhënat mbi integritetin</b></p> <p>Përmirësimi i platformës digjitale të Agjencisë për</p>	<p>API publike funksionale që ofron qasje të strukturuar në grupe të përzgjedhura të të dhënave mbi deklarimin e pasurisë dhe monitorimin e</p>	Q3 2026 (Korrik 2026)	Udhëheqës: Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK)		
			Akterët mbështetës		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)

<p>Parandalimin e Korrupsionit për të mundësuar qasje të strukturuar publike në të dhënat që lidhen me integritetin. Ky hap përfshin vënien në funksion të një API-je publike dhe përditësimin e moduleve të përzgjedhura të platformës, me qëllim mbështetjen e publikimit të standardizuar të informacionit kyç mbi integritetin.</p>	<p>integritetit</p> <p>Platformë digjitale e përmirësuar e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me module të avancuara për publikimin e informacionit që lidhet me integritetin</p> <p>Regjistër publik online i pozitive të deklarueshme, në dispozicion në format të kërkueshëm dhe të shkarkueshëm</p> <p>Raporte të publikuara rregullisht nga monitorimi sistematik i zbatimit të planeve të integritetit në institucionet publike</p> <p>Dokumentacion teknik dhe udhëzues për përdoruesit mbi qasjen dhe përdorimin e grupeve të të dhënave të publikuara.</p>		<p>Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK)</p>	<p>Organizatave shoqërisë civile si bashkëzbatues, si dhe organizata të tjera, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës të OSHC-ve, përfshirë organizatat që veprojnë në nivel komunal.</p>	<p>Asociacioni i Komunave të Kosovës, Donatorët etj.</p>
---	---	--	---	--	--

## Zotimi 5: Fuqizimi i mekanizmave për koordinim dhe monitorim të zbatimit të Planit të Veprimit për Qeverisje të Hapur 2026-2028

<b>Numri dhe Emri i Zotimit</b>	<b>Nr. 5 Fuqizimi i mekanizmave për koordinim dhe monitorim të zbatimit të Planit të Veprimit për Qeverisje të Hapur 2026-2028</b>		
<b>Përshkrim i shkurtër i zotimit</b>	Ky zotim krijon një kornizë të thjeshtë, por të strukturuar koordinimi dhe monitorimi për të mbështetur zbatimin efektiv të Planit të Veprimit për Qeverisje të Hapur 2026–2028. Ai parashikon përcjellje të rregullt të progresit të zbatimit, shkëmbime ndërinstucionale për mësim dhe mekanizma të përbashkët raportimi, me qëllim rritjen e llogaridhënies, përmirësimin e zgjidhjes së problemeve dhe zgjerimin e praktikave të suksesshme. Kjo kornizë forcon bashkëpunimin ndërmjet institucioneve zbatuese, organizatave të shoqërisë civile dhe Forumit Kombëtar për Qeverisje të Hapur, duke siguruar që angazhimet të zbatohen në mënyrë të qëndrueshme dhe që mësimet e nxjerra të dokumentohen dhe të shfrytëzohen në mënyrë sistematike.		
<b>Institucioni udhëheqës i zotimit</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)		
<b>Akterët mbështetës</b>	<b>Qeveria</b>	<b>Shoqëria Civile</b>	<b>Akterët tjerë (Parlamenti, Sektori Privat, etj)</b>
	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)	<i>Shoqëria civile dhe OJQ-të</i>	Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj
<b>Periudha kohore</b>	2026-2028		

### Përkufizimi i Problemit

#### 1. Çfarë problemi synon të adresojë zotimi?

Planet e mëparshme të Veprimit për Qeverisje të Hapur janë përballur me boshllëqe në zbatim për shkak të koordinimit të fragmentuar, monitorimit të parregullt dhe të nxënimit të kufizuar institucional përmes zotimeve. Përgjegjësitë për përcjelljen e progresit shpesh kanë qenë të paqarta, dhe sfidat gjatë zbatimit nuk janë adresuar në kohë ose në mënyrë të koordinuar. Si rezultat, iniciativat premtuese kanë hasur vështirësi në zgjerim dhe qëndrueshmëri, dhe njohuritë institucionale nuk janë dokumentuar apo transferuar në mënyrë sistematike. Kjo situatë ndikon negativisht te institucionet zbatuese, partnerët e shoqërisë civile dhe qytetarët, të cilët mbështeten në realizimin e besueshëm të reformave për qeverisje të hapur.

#### 2. Cilat janë shkaqet e problemit?

Shkaqet rrënjësore përfshijnë mungesën e një mekanizmi të strukturuar koordinimi ndërinstucional, monitorimin e kufizuar dhe jo të rregullt të progresit të zbatimit, si dhe mungesën e platformave efektive për shkëmbimin e mësimave të nxjerra ndërmjet institucioneve. Monitorimi shpesh është fokusuar në raportim formal, në vend që të shërbejë si mjet për zgjidhje praktike të problemeve, dhe mundësitë për të mësuar nga njëri-tjetri dhe për të pasur përmirësim janë shfrytëzuar pak. Këto boshllëqe strukturore e ulin efektivitetin e zbatimit dhe rrisin rrezikun e vonësave apo realizimit të pjesshëm të zotimeve.

## Përshkrimi i Zotimit

### 4. Çfarë është bërë deri më tani për ta zgjidhur problemin?

Në Planin e Veprimit për Qeverisje të Hapur 2023–2025, Kosova prezantoi disa rregullime për koordinim dhe monitorim përmes forumit të shumëpalësh të Qeverisjes së Hapur dhe raportimit periodik nga institucionet zbatuese. Cikli i mëparshëm mbështeti dialogun ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile për disa iniciativa që lidhen me transparencën, qeverisjen digjitale dhe pjesëmarrjen qytetare.

Megjithatë, monitorimi dhe koordinimi nuk ishin të mbështetur nga një kornizë plotësisht e strukturuar dhe e parashikueshme për përcjelljen rutinore të zbatimit dhe të nxënit institucional. Praktikat e raportimit ndryshonin ndërmjet institucioneve, dhe sfidat e zbatimit nuk identifikoheshin apo nuk adresoheshin gjithmonë në kohë dhe në mënyrë të koordinuar. Mundësitë për të mësuar në mënyrë sistematike nga përvoja e institucioneve të tjera dhe për përshtatje gjatë periudhës së zbatimit ishin të kufizuara, dhe mësimet e nxjerra nuk dokumentoheshin dhe nuk shpërndareshin në mënyrë të strukturuar ndërmjet zotimeve përkatëse.

Ndonëse Plani i Veprimit i mëparshëm krijoi baza të rëndësishme për reformën e qeverisjes së hapur, ai nuk institucionalizoi një mekanizëm koordinimi ndër-institucional që të mundësonte mbikëqyrje të qëndrueshme të zbatimit dhe menaxhimit të adaptueshëm. Zotimi i propozuar është i krijuar drejtpërdrejt mbi këtë përvojë, duke prezantuar një kornizë të strukturuar koordinimi dhe monitorimi, e cila synon të forcojë disiplinën në zbatim, të nxjerrë mësimet të përbashkëta dhe të bëjë zgjidhjen e problemeve me anë të bashkëpunimit.

### 5. Çfarë zgjidhjeje po propozoni?

Ky zotim krijon një kornizë të thjeshtë, por të strukturuar koordinimi dhe monitorimi për të mbështetur zbatimin efektiv të Planit të Veprimit për Qeverisje të Hapur. Kjo kornizë përfshinë përcjelljen e rregullt të progresit të zbatimit, një proces vlerësimi në mes të periudhës dhe mundësi të strukturuar për të mësuar nga përvoja ndër-institucionale si dhe zgjidhjen e problemeve.

Ndryshe nga ciklet e mëparshme, ku koordinimi mbështetej kryesisht në raportime të rastësishme dhe takime periodike, zgjidhja e propozuar krijon një rutinë ose sistem të parashikueshëm të zbatimit. Institucionet udhëheqëse do të marrin pjesë në përcjelljen rutinore të progresit, takime të përbashkëta për rishikim dhe një vlerësim në mes të periudhës, i cili mundëson identifikimin në kohë të sfidave dhe rregullime bashkëpunuese. Një funksion qendror koordinues do të konsolidojë informacionin mbi progresin, do të lehtësojë komunikimin ndërmjet institucioneve dhe partnerëve të shoqërisë civile, dhe do të dokumentojë mësimet e nxjerra.

Kjo qasje forcon zbatimin duke krijuar cikle të qarta reagimi ndërmjet monitorimit, vendimmarrjes dhe veprimeve korrigjuese. Ajo promovon identifikimin e hershëm të rreziqeve, mbështet përgjigje të koordinuara ndaj sfidave të zbatimit dhe nxit mësimin ndërmjet bashkëmoshatarëve nëpër zotime të ndryshme.

Ky zotim nuk synon të zgjidhë të gjitha sfidat që lidhen me reformat e qeverisjes së hapur. Ai adreson një boshllëk strukturorë kritik: mungesën e një kornize të qëndrueshme ndërprerëse për përcjelljen e progresit dhe të mësuarit nga përvoja e zbatimit. Duke përmirësuar disiplinën në koordinim, transparencën e zbatimit dhe menaxhimin e adaptueshëm, kjo kornizë rrit mundësinë që zotimet individuale të realizohen në mënyrë efektive dhe të mund të zgjerohen në planet e ardhshme të veprimit.

### 6. Çfarë rezultatesh duam të arrijmë duke zbatuar këtë zotim?

Zbatimi i këtij zotimi pritet të prodhojë si rezultate konkrete funksionimi ashtu edhe përmirësime afatgjata në mënyrën se si koordinohen dhe zbatohen reformat e qeverisjes së hapur.

#### Rezultatet

- Një sistem i strukturuar për përcjelljen e zbatimit që mbulon të gjitha zotimet e Planit të Veprimit
- Raporte të rregullta të konsoliduara mbi progresin, që dokumentojnë statusin e zbatimit
- Një proces rishikimi në mes të periudhës, duke përfshirë vetëvlerësimin institucional dhe një punëtor kombëtar me shumë palë të interesit

- Takime periodike koordinimi dhe mësimi ndërmjet institucioneve zbatuese
- Një panel ose mjet i përbashkët për përcjelljen e zbatimit, i qasshëm për akterët relevant
- Mësime të dokumentuara dhe rekomandime praktike për përmirësimin e zbatimit dhe zgjerimin e praktikave të suksesshme

#### **Ndryshime në njohuri, kapacitete dhe praktika**

- Rritje e kapaciteteve institucionale për të monitoruar dhe menaxhuar zbatimin e zotimeve për qeverisje të hapur
- Koordinim më i parashikueshëm dhe më i disiplinuar ndërmjet institucioneve zbatuese
- Identifikim dhe zgjidhje më e shpejtë e sfidave gjatë zbatimit
- Përmirësim i kulturës së të mësuarit institucional dhe i përshtatjes së bazuar në evidencë
- Rritje e transparencës dhe llogaridhënies në përcjelljen e progresit të Planit të Veprimit
- Bashkëpunim më i madh ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile gjatë zbatimit

Ky zotim synon të fuqizoj mjedisin e zbatimit të Planit të Veprimit dhe jo të zëvendësojë reformat sektoriale. Duke përmirësuar disiplinën në koordinim dhe menaxhimin e adaptueshëm, rriten gjasat që zotimet individuale të zbatohen në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.

<b>Analiza e Zotimit</b>	
<b>Pyetjet</b>	<b>Përgjigje (nëse nuk është e aplikueshme, përgjigjuni vetëm me N/A)</b>
1. Si do ta promovojë transparencën zotimi?	<p>Ky zotim promovon transparencën duke prezantuar një sistem gjurmimi sistematik dhe publikisht të dukshëm të zbatimit të Planit të Veprimit. Raportet e rregullta të konsoliduara të progresit dhe gjetjet e rishikimit në mes të periudhës do të dokumentojnë statusin e zotimeve, sfidat e zbatimit dhe masat korrigjuese të dakorduara. Bërja publike e këtij informacioni për palët e interesuara rrit dukshmërinë mbi progresin e reformave të qeverisjes së hapur. Sistemi i përbashkët i gjurmimit të zbatimit dhe proceset periodike të rishikimit krijojnë dokumentim më të qartë dhe më të qëndrueshëm të veprimeve të institucioneve.</p> <p>Qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe palë të tjera të interesuara do të kenë qasje më të mirë në informacion të strukturuar mbi atë që është zbatuar, çfarë mbetet ende pezull dhe si po i adresojnë institucionet sfidat.</p> <p>Duke fuqizuar dokumentimin rutinor dhe komunikimin mbi progresin e zbatimit, ky zotim rrit transparencën e performancës qeveritare dhe mbështet mbikëqyrjen më të informuar publike të reformave për qeverisje të hapur.</p>
2. Si do të ndihmojë zotimi në nxitjen e llogaridhënies?	<p>Ky zotim forcon llogaridhënien duke pasur monitorim të rregullt dhe të strukturuar të zbatimit të Planit të Veprimit. Raportet e konsoliduara të progresit dhe gjetjet e rishikimit në mes të periudhës e bëjnë të dukshme performancën institucionale dhe krijojnë pritshmëri të qarta për veprime pasuese. Duke ofruar informacion të qasshëm dhe të qëndrueshëm mbi progresin e zbatimit, korniza u mundëson qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile të përcjellin se si po realizohen zotimet dhe të mbajnë institucionet përgjegjëse për rezultatet.</p>
3. Si do ta përmirësojë zotimi pjesëmarrjen e qytetarëve në përcaktimin, zbatimin dhe monitorimin e zgjidhjeve?	<p>Ky angazhim përmirëson pjesëmarrjen e qytetarëve duke krijuar mundësi të strukturuar për shoqërinë civile dhe palë të tjera të interesuara që të angazhohen në monitorimin dhe rishikimin e zbatimit të Planit të Veprimit. Përmes punëtorisë së rishikimit në mes të periudhës me shumë palë të interesuara dhe proceseve të</p>

	rregullta të koordinimit, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile mund të japin komente, të ngrenë shqetësime lidhur me zbatimin dhe të kontribuojnë në përshtatjet e dakorduara. Duke e bërë progresin e zbatimit më të dukshëm dhe duke hapur kanale formale për dialog gjatë ciklit të rishikimit, ky zotim mbështet pjesëmarrjen më të informuar dhe më domethënëse të palëve të interesuara në formësimin e mënyrës se si zbatohen reformat për qeverisje të hapur.
--	---

**Planifikimi i Zotimeve**

<b>Pikat/etapat kyçe</b>	<b>Rezultatet e pritura</b>	<b>Data e pritur e përfundimit</b>	<b>Akterët</b>		
Krijimi i një kornize për koordinim dhe gjurmim të zbatimit	<p>Caktimi i një pike qëndrore koordinuese dhe i personave kontaktues institucional.</p> <p>Metodologji e dakorduar për gjurmimin e zbatimit dhe një format raportimi.</p> <p>Krijimi i një paneli të përbashkët (eng. dashboard) ose mjete për gjurmimin e zbatimit.</p> <p>Miratimi i një kalendarit vjetor të koordinimit</p>	Q2 2026	Udhëheqës: MAPL		
			<u>Akterët mbështetës</u>		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)
			MAPL dhe institucionet kryesore të të gjitha zotimeve	Shoqëria civile dhe OJQ-të	Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj
Gjurmimi dhe raportimi i rregullt i zbatimit	<p>Raporte të konsoliduara gjashtë mujore mbi zbatimin e Planit të Veprimit</p> <p>Takime periodike koordinuese ndërmjet institucioneve zbatuese.</p> <p>Përditësim i panelit (dashboard) të zbatimit që pasqyron progresin.</p>	Vazhdon (2026–2028)	Udhëheqës:		
			<u>Akterët mbështetës</u>		
			Qeveria	Shoqëria civile dhe OJQ-të	Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)
			MAPL dhe institucionet kryesore të të gjitha zotimeve	Shoqëria civile dhe OJQ-të	Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj

Rishikimi në mes të periudhës dhe përshtatja e adaptueshme	<p>Raportet vetëvlerësimi institucional të përgatitura nga institucionet udhëheqëse</p> <p>Organizimi i një punëtorie kombëtare të rishikimit në mes të periudhës me shumë palë të interesuara</p> <p>Raport përmbledhës i konsoliduar i rishikimit në mes të periudhës</p> <p>Përshtatje të dakorduara të zbatimit dhe veprime pasuese.</p>	Q1 2027	Udhëheqës:		
			Akte të mbështetës		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)
			MAPL dhe institucionet kryesore të të gjitha zotimeve	OSHC-të: Anëtarët e forumit kombëtar për QH	Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj
Vlerësimi përfundimtar dhe shkëmbimi i njohurive	<p>Raport i rishikimit të zbatimit në fund të procesit (ciklit).</p> <p>Dokumentim i mësimave të nxjerra dhe praktikave të mira.</p> <p>Rekomandime për Planin e ardhshëm të Veprimit</p> <p>Shpërndarje publike e gjetjeve.</p>	Q4 2028	Udhëheqës:		
			Akte të mbështetës		
			Qeveria	OSHC-të	Të tjerët (p.sh., Parlament i, Sektori privat etj)
			MAPL dhe institucionet kryesore të të gjitha zotimeve	OSHC-të: Anëtarët e forumit kombëtar për QH	Asociacioni i Komunave të Kosovës; Donatorët etj

## Kapitulli IV: Zbatimi dhe monitorimi

Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për zbatimin efektiv, transparent dhe të përgjegjshëm të Planit të Veprimit. Një kornizë e fuqishme për Monitorim, Vlerësim, Mësim dhe Komunikim (MVMK) do ta udhëheqë zbatimin, do të sigurojë që angazhimet të përkthehen në veprime konkrete dhe të matshme, si dhe do të mundësojë përmirësim të vazhdueshëm gjatë gjithë ciklit të Planit të Veprimit.

**Përmirësimet e zbatimit:** Çdo zotim do të zbatohet nën udhëheqjen e institucionit kryesor të caktuar, në koordinim të ngushtë me organet mbështetëse të qeverisë, organizatat e shoqërisë civile dhe palët e tjera të interesit të cilat janë relevante. Roli dhe përgjegjësitë e qarta do të përcaktohen që në fillim të zbatimit për të siguruar pronësinë nga secila palë, koordinimin dhe llogaridhënien. Institucionet kryesuese do të jenë përgjegjëse për arritjen e objektivave të dakorduara, raportimin mbi progresin dhe adresimin e sfidave të zbatimit më kohë.

Kur është e nevojshme, do të përdoren mekanizma ndër-institucionalë të koordinimit për të siguruar qëndrueshmëri ndërmjet zotimeve, për të shmangur dyfishimin dhe për të maksimizuar koordinimin ndërmjet institucioneve në zbatimin e reformave në vazhdim, si dhe strategjive sektoriale dhe iniciativave të transformimit digjital. Do t'u ofrohet mbështetje kapaciteteve administrative dhe teknike përmes udhëzimeve, trajnimeve dhe shkëmbimit ndërmjet kolegëve.

**Monitorimi dhe raportimi:** Progresi i çdo zotimi do të monitorohet në bazë të objektivave, rezultateve dhe treguesve të paraqitur në format të raportimit. Institucionet kryesuese do të sigurojnë përditësime të rregullta mbi progresin duke përdorur një format të standardizuar raportimi, për të mundësuar qasjen të qëndrueshme në të gjithë Planin e Veprimit.

Të dhënat e monitorimit do të përfshijnë: si tregues sasior (p.sh., aktivitete të përfunduara, rezultate të dorëzuara, kohëzgjatja e përgjigjeve) ashtu edhe informacion cilësor (p.sh., sfidat e hasura dhe mësimet e nxjerra). Rezultatet e monitorimit do të shkëmbehen kohë pas kohe me Forumin Kombëtar për Qeverisje të Hapur dhe do të publikohen përmes kanaleve të përshtatshme për të siguruar transparencë dhe mbikëqyrje publike. Kjo qasje do t'u mundësojë qytetarëve, shoqërisë civile dhe mediave të përcjellin progresin e zbatimit dhe të mbajnë institucionet përgjegjëse.

**Vlerësimi dhe mësimi:** Do të realizohen vlerësime në mes të periudhës dhe në fund të ciklit për të analizuar progresin, efektivitetin dhe rëndësinë e zotimeve. Vlerësimet nuk do të fokusohen vetëm në realizimin e produkteve (outputeve), por edhe në rezultatet (outcomes), si ndryshimet në praktikat institucionale, cilësinë e angazhimit të qytetarëve dhe nivelin e besimit në institucionet publike. Gjetjet nga vlerësimet do të përdoren për të ndërmarr masa korrigjuese gjatë zbatimit dhe për të orientuar hartimin e Planeve të ardhshme të Veprimit. Mësimet e nxjerra, praktikat e mira dhe sfidat do të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe do të shkëmbehen ndërmjet institucioneve zbatuese dhe palëve të interesuara për të mbështetur mësimin e vazhdueshëm dhe përshtatjen.

**Komunikimi dhe angazhimi publik:** Komunikimi transparent dhe proaktiv është pjesë përbërëse e kornizës MVMK. Informacioni mbi zotimet, progresin e zbatimit dhe rezultatet do të komunikohen në formate të qarta dhe të qasshme përmes platformave digjitale dhe kanaleve tjera të përshtatshme. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet komunikimit të progresit në mënyra që janë të kuptueshme për qytetarët dhe gjithëpërfshirëse për audiencë të ndryshme. Organizatat e shoqërisë civile do të kenë rol të rëndësishëm në informim, mbledhjen e komenteve dhe monitorimin e pavarur, duke kontribuar në një proces zbatimi bashkëpunues dhe pjesëmarrës. Komunikimi i hapur do të forcojë besimin, do të inkurajojë angazhimin dhe do të përforcojë parimet e qeverisjes së hapur gjatë gjithë ciklit të Planit të Veprimit.

## 4.1. Qeverisja dhe koordinimi

Koordinimi i përgjithshëm i Planit të Veprimit do të udhëhiqet nga **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)**. Një Komitet Drejtues i PQH-së me shumë palë të interesuara, i bashkëkryesuar nga përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile, do të jetë organi kryesor për mbikëqyrjen e zbatimit. Forumi Kombëtar për Qeverisje të Hapur do të mbledhet çdo tre muaj për të:

- Shqyrtuar progresin e secilit zotim në raport me objektivat e përcaktuara.
- Identifikuar dhe adresuar sfidat dhe pengesat në zbatim.
- Lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve udhëheqëse, partnerëve mbështetës dhe shoqërisë civile.
- Siguruar që parimet e qeverisjes së hapur të respektohen gjatë gjithë procesit të zbatimit.
- 

## 4.2. Procesi i shqyrtimit në mes të periudhës

Një komponent thelbësor i këtij Plani të Veprimit është **rishikimi formal në mes të periudhës**, i cili do të realizohet pas vitit të parë të zbatimit (afërsisht në TM1 2027). Ky rishikim do të shërbejë si një mundësi e strukturuar për të vlerësuar ndërlidhjen, efektivitetin dhe efikasitetin e planit, si dhe për të bërë përshtatjet e nevojshme.

Procesi i rishikimit në mes të periudhës do të përfshijë:

- **Vetëvlerësimin:** Institucionet udhëheqëse do të përgatisin një raport të plotë vetëvlerësimi mbi progresin e arritur, sfidat e hasura dhe mësimet e nxjerra.
- **Punëtorinë me shumë palë të interesuara:** Do të organizohet një punëtori kombëtar për të diskutuar gjetjet e raporteve të vetëvlerësimit. Kjo punëtori do të ofrojë një platformë për të gjitha palët e interesuara që të japin komente dhe të bien dakord në mënyrë bashkëpunuese për çdo korrigjim të nevojshëm të rrjedhës së veprimit.

Bazuar në rezultatet e rishikimit, Forumi Kombëtar për Qeverisje të Hapur mund të rekomandojë përshtatje të Planit të Veprimit, si rishikimin e objektivave, rialokimin e burimeve ose ndryshimin e strategjive të zbatimit, për të siguruar që plani të mbetet në rrugën e duhur drejt arritjes së objektivave të tij. Kjo qasje e menaxhimit adaptiv bënë që Plani i Veprimit të jetë një dokument dinamik, i cili mund të ndryshohet varësisht nga rrethanat dhe mundësitë e reja që vijnë, duke maksimizuar kështu potencialin e tij për ndikim.